



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në
“Biologji Kimi”
ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë
Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastër**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Mirela Lika (Çekani)

2. Prof. Dr. Anila Hoda

Shtator/ 2024

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 1

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Bachelor në “Biologji Kimi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Biologji Kimi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë VKM nr. 414 prot., datë 12.11.1991
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASh Nr. 334, datë 13.07.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total [ECTS]:	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha [shqip/tjetër]:	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët [shëno emërtimin]:	-
15	Diplomë e dyfishtë [shëno emërtimin]:	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	8 PAE/ 6 PAK
18	Numri i studentëve: [v.a 21- 24]	28 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në Biologji-Kimi në Universitetin "Eqrem Çabej" në Gjirokastrë është një program i ciklit të parë të studimeve që ka një histori të pasur dhe traditë të gjatë, duke filluar që nga viti 1980 në Institutin e Lartë Pedagogjik të Gjirokastrës. Ky program zhvillohet në Departamentin e Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit, i cili është pasardhës i Katedrës së Kimi-Biologjisë.

Departamenti i Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit ka përgjegjësi për organizimin e dy programeve studimore: një program cikli të parë studimi Bachelor dhe një program cikli të dytë studimi Master në Mesuesi. Programi Bachelor në Biologji-Kimi ka reflektuar ndryshimet ligjore dhe kërkesat e tregut të punës, duke u përshtatur me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akte tjera ligjore.

Për të fituar diplomën Bachelor në Biologji-Kimi, studentët duhet të përfundojnë 180 kredite ECTS, duke përfshirë 60 kredite ECTS për një çdo akademik. Programi ofron një kombinim të lëndëve të fushave të ndryshme, duke përfshirë biologjinë, kiminë, dhe fusha të tjera relevante. Në këtë rrugëtim studimor, studentët përfitojnë njohuri të thella dhe aftësi të zhvilluara në fushat e biologjisë, mjedisit, dhe kimisë, duke u përgatitur për sfidat e punës dhe të kërkimit shkencor. Programi është i strukturuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe ofron mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta dhe të specializuara në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Studentët gjithashtu kanë mundësinë të përfshihen në aktivitete të veçanta, si shkrim dhe menaxhim projektesh, që i ndihmojnë ata në zhvillimin e aftësive të menaxhimit, komunikimit dhe bashkëpunimit në grup.

Programi fokusohet në përdorimin e metodave dhe teknologjive të fundit, duke përgatitur studentët për të kontribuar në zhvillimin e dijes në këto fusha. Personeli akademik është i kualifikuar dhe ndjek një qasje të personalizuar në mësimdhënie, duke ofruar orientim dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët në zhvillimin e tyre shkollor dhe profesional.

Përfundimi i programit të studimit realizohet me me provimin përfundimtar ose mbrojtjen e punimit të diplomës, para një komisioni. Procesi i vlerësimit është transparent dhe i drejtuar nga kriteret dhe standardet e përcaktuara në rregulloret dhe ligjet e arsimit të lartë në Shqipëri. Studentët, pas përfundimit të programit, pajisen me diplomë dhe suplement të diplomës që japin informacion mbi njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve. Përgjegjësia për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve është e siguruar në përputhje me legjislacionin dhe parimet e konfidencialitetit, duke u mundësuar studentëve që të kenë akses në informacione rast pas rasti në mbyllje të studimeve.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të programit të studimit Bachelor në Biologji-Kimi në Universitetin "Eqrem Çabej" në Gjirokastrë ka filluar me një propozim nga Njësia Bazë e Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit, e cila është përgjegjëse për këtë program. Ky aplikim është përcjellë me shkresë zyrtare me shkresën nr. 1685, datë 15.12.2022. Përmes një letre zyrtare të re, me shkresën nr. 117/1, datë 06.03.2023, ASCAL konfirmon aplikimin për akreditim të 20 programeve të studimit.

Në bazë të informacionit më lart, Grupi i Vlerësimit të Brendshëm [GVB] është krijuar me vendim nr. 6, datë 29.03.2023, duke u bazuar në propozimin e drejtuesit të Njesisë Bazë të Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit. Raporti i vlerësimit të brendshëm është përgatitur nga një ekip i Departamentit të Biologjisë-Kimisë, i cili është miratuar me vendim të departamentit në datë 19.05.2022. Ky ekip përfshin anëtarë të stafit akademik, si dhe një përfaqësues të studentëve.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm [GVB] ka hartuar raportin e tyre duke përdorur dokumente të shumta. GVB ka konkluduar se standardet janë përmbushur plotësisht në të gjashtë fushat e vlerësimit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm [GVJ] përbëhet nga Profesoret Anila Hoda dhe Mirela Lika dhe është mbështetur nga Koordinator Teknik Znj. Aviola Bardhi përfaqësues i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë [ASCAL].

GVJ është mbështetur në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm [RVB] dhe një sërë evidencash të ndryshme që i janë vënë në dispozicion më herët. Përmes vizitës së tyre në institucion, GVJ është njohur më shumë me strukturën, politikën, menaxhimin dhe natyrën e mësimdhënies dhe aktiviteteve kërkimore të Departamentit. Përmes takimeve me përfaqësues të ndryshëm dhe vizitës në ambientet e brendshme të institucionit, GVJ ka arritur në konkluzione të detajuara.

Më datë 29.08.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 85/41 Prot., datë 29.08.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 02.09.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 1251/ 1, datë 02.09.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Biologji Kimi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë [UGJ], duke u referuar Statutit të tij dhe misionit, ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, duke synuar ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare [Evidenca 1.1, Neni 2, Neni 8]. Për të vërtetuar këtë, në misionin e tij, UGJ shprehet se synon të mbështesë prioritetet strategjike dhe intelektuale të vendit, duke përgatitur shkencëtarë të rinj në përputhje me zhvillimin e vendit dhe duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë [Evidenca 1.1, Neni 5, pika 5, Neni 8, pika 5]. GVJ gjykon se UGJ ofron programe studimi që ndjekin synimet akademike dhe kulturore kombëtare dhe se veprimtaria e tij është në përputhje me këto qëllime.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë [UGJ], ka përcaktuar misionin e tij për të mbështetur prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit, siç është shprehur në Statutin e Universitetit [Evidenca 1.1, Neni 8, pika 5]. Programet e studimeve, duke përfshirë atë të Bachelor në “Biologji – Kimi”, janë hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së, të shprehura në Statutin e UGJ-së [Evidenca 1.1, Nenet 4, 5, 8] dhe Strategjinë e Zhvillimit të UGJ [Evidenca 1.3, Misioni, fq 8, Vizioni, fq 8]. Ky program synon të ofrojë një formim bazë në Biologji dhe Kimi për studentët, duke shërbyer si platformë për punësim ose vazhdim të studimeve në nivelet më të larta në fushat e Biologjisë dhe Kimisë [Evidenca 1.9, Neni 5]. GVJ gjykon se programi i studimit është në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij.
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në “Biologji - Kimi” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të Universitetit [Evidenca 1.3, fq 8, Vizioni fq 8], Statutin e UGJ-së [Evidenca 1.1, Nenet 62, 63, 65], Rregulloren e UGJ-së [Evidenca 1.2, Nenet 42, 46, 48], dhe drejtimet akademike të UGJ-së. Programi është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së për të zhvilluar, ndjekur dhe mbrojtur dijen përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, për të formuar specialistë dhe shkencëtarë të rinj, dhe për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal. Synimi i programit është të ofrojë një formim bazë në Biologji dhe Kimi,

	që do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program, si një bazë për punësim ose për vazhdim të kualifikimit në nivelet e larta të studimeve në fushat e Biologjisë dhe Kimisë [Evidence 1.0, Neni 5]. Ekziston një lidhje e qëndrueshme midis programit të studimit dhe strategjive, si dhe dokumenteve zyrtare të Universitetit 'Eqrem Çabej', duke përfshirë edhe synimet dhe misionin e institucionit.			
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UGJ, një institucion i arsimit të lartë, është themeluar më 1971 [Evidence 1.18, Evidence 1.18.1. Ky institucion ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për të ofruar programin Bachelor në "Biologji - Kimi" [Evidence 1.21]. UGJ-ja ka një bazë të fortë në përvojë dhe kapacitete [Vizita në institucion] për të ofruar programin studimor në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. Referencat specifike të vendimeve zyrtare ndihmojnë në rritjen e besueshmërisë dhe sigurimit të burimeve të nevojshme për këtë program.			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në Biologji - Kimi është një program i nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së [Evidence 1.1, Nenet 5, 63]. Fusha e përgjithshme dhe specifike e këtij programi është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të Fakultetit të Shkencave të Natyrës [Evidence 1.6, Nenet 2, 5], si dhe me fushën akademike dhe kërkimore të personelit akademik në këtë program studimi [Evidence 1.17]. Departamenti i Shkencave të Mjedisit dhe Biologjisë Molekulare dhe Ushqimore [DSHBMU] ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" në përputhje me ligjin dhe vendimet relevante [Evidence 1.22, Evidence 1.22.1]. Programi është i nivelit të duhur sipas standardeve kombëtare, dhe fusha e tij akademike është në përputhje me udhëzimet dhe klasifikimet e programeve të studimit.			
Konkluzione	- Universiteti 'Eqrem Çabej' në Gjirokastrë ofron programin Bachelor në "Biologji - Kimi" në përputhje me synimet kombëtare dhe qëllimet e tij, siç përcaktohen në dokumentet zyrtare si Statuti, Rregulloret, dhe Strategjia e Zhvillimit. - Programi është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e UGJ-së, duke shërbyer si bazë për formimin e specialistëve në Biologji dhe Kimi. - UGJ ka demonstruar përvojën dhe kapacitetet e duhura për ofrimin e këtij programi. GVJ konkludon se Universiteti 'Eqrem Çabej' nëpërmjet këtij programi kontribuon në zhvillimin e dijes, duke siguruar formim bazë për studentët në fushën e Biologjisë dhe Kimisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, Universiteti 'Eqrem Çabej', Gjirokastër [UGJ], ka caktuar dhe zbatuar me përpikëri marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit. Ky proces ndodh përmes ndarjes së detyrave në mes të njërive dhe personelit, duke përcaktuar përgjegjësitë përkatëse për secilën palë. Rregullimi i këtyre marrëdhënieve dhe analiza e vazhdueshme e performancës janë rregulluar dhe koordinuar në përputhje me dispozitat e Statutit dhe Rregullores së UGJ-së. Gjithashtu, është theksuar që këto praktika janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" [Evidenca 1.1; 1.2; 1.3]. Në këtë kontekst, struktura e Departamentit dhe ndarja e detyrave janë të rregulluara dhe shpjeguara në Statutin e UGJ-së dhe Rregulloren specifike të institucionit.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor e formues të studentëve, Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër [UGJ], ka përcaktuar dhe implementuar marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të biznesit vendas dhe ndërkombëtarë. Ky bashkëpunim është në përputhje me prioritetet dhe politikat e zhvillimit të institucionit, të cilat janë të theksuara në Strategjinë e Zhvillimit të UGJ-së për periudhën 2020-2025 [Evidenca 1.3]. Ky bashkëpunim është konkretizuar nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të tjera, si dhe me institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Lista e këtyre marrëveshjeve është dokumentuar dhe është në dispozicion të publikut [Evidenca 1.23; 1.24; 1.25]. Përmes këtyre marrëveshjeve, UGJ siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi, duke përfshirë përfitime për studentët dhe personelin akademik. Realizimi i aktiviteteve në kuadër të këtyre marrëveshjeve dhe projektet e ndryshme shënohet në raportet vjetore institucionale të UGJ-së [Evidenca 1.11; 1.II.2; 1.II.4; 1.II.6].
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<i>Institucioni deklaron se nuk përmban në programin mësimor zhvillim të praktikës profesionale.</i> GVJ e konsideron këtë si një pikë të dobët dhe i rekomandon institucionit të përmbushë detyrimet sipas vendim nr. 879, datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të këshillit të ministrave, "për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" ku për programet Bachelor, kategoria e lëndëve plotësuese [10-15% kredite] përfshin dhe praktikën profesionale. Përfshirja e praktikës profesionale në planin mësimor duhet të shoqërohet me nënshkrimin e marrëveshjeve të

	posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani sipas fushës së studimit.			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit për realizimin e programit të studimit, zhvillon raporte analitike të përfitimeve nga keto marrëveshje [Evidenca 1.29]. Ky departament prezanton të dhëna të detajuara lidhur me përfitimet dhe arritjet e realizuara përmes bashkëpunimit në raportet vjetore të veprimtarisë mësimore-kërkimore [Evidenca 1.13; 1.13.1; 1.13.2; 1.13.3]. Departamenti harton raporte analitike periodike për të vlerësuar përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të programit të studimit.			
Konkluzione	- Universiteti 'Eqrem Çabej' në Gjirokastrë ka caktuar dhe zbatuar me përpikëri marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit për hartimin, mbikëqyrjen, dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit. - Struktura e Departamentit dhe ndarja e detyrave janë të rregulluara në përputhje me dokumentet zyrtare të institucionit. Gjatë procesit mësimor dhe formues të studentëve, UGJ ka implementuar me sukses marrëdhëniet e bashkëpunimit me institucionet homologe, aktorë të biznesit vendës dhe ndërkombëtarë, duke u përshtatur me prioritetet dhe politikat e zhvillimit të institucionit. - Bashkëpunimi konkretizohet nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete të tjera dhe institucione lokale dhe ndërkombëtare. Ky bashkëpunim siguron përfitime të ndryshme për studentët dhe personelin akademik, ndërsa aktivitetet dhe projektet realizohen me sukses, evidentuar në raportet vjetore të institucionit. - UGJ nuk ka përfshirë zhvillimin e praktikës profesionale në programin mësimor, dhe GVJ e konsideron si një pikë të dobët. GVJ rekomandon institucionin përmbushjen e detyrimeve sipas Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019, që parashikon përfshirjen e praktikës profesionale në programet Bachelor. Kjo përfshirje duhet shoqëruar me marrëveshje të posaçme me institucione dhe kompani sipas fushës së studimit. - Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, nëpërmjet raporteve analitike, prezanton përfitimet dhe arritjet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, duke hartuar raporte periodike për vlerësimin e këtyre përfitimeve në funksion të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve [ECTS].	Programi i studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" organizohet në lëndë e module, duke përfshirë elemente të strukturuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve [ECTS]. Ky program ka një kohëzgjatje normale prej 3 vitesh akademike dhe përbëhet nga një total prej 180 ECTS [Evidenca 1.4; 1.9; II.9.1]. Elementet e programit të studimit për "Biologji - Kimi" janë në përputhje të plotë me vendimet ligjore, përfshirë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, 'Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë'", dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, 'Për elementët e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë', të Ndryshuar" [Evidenca II.3, II.3.1, II.3.2]. Në përfundim të studimeve, studentëve që kryejnë këtë program studimi u jepet diploma Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidenca 1.4, 1.9, II.5].
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Qellimi i programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" është të ofrojë një formim bazë në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. Ky program synon të pajisë studentët me njohuri bashkëkohore në këto fusha, duke i përgatitur ata për punësim ose për vazhdim të studimeve në nivelet më të larta në biologji, kiminë apo programe të tjera të ngjashme [Evidenca II.9.1, II.30,]. Për të arritur këtë qëllim, programi synon: • T'i ofrojë studentëve një formim thelbësor në disiplinat biokimike, që do të ulet si baza e tyre për punësim ose për vazhdim të studimeve në nivelet më të larta në biologji, kiminë apo programe të tjera relevante. • T'i hapë mundësi studentëve për futjen e informacionit të ri nga fushat biologjike dhe kimike, duke i përgatitur ata për zhvillimet aktuale dhe të ardhmen në fushën e arsimit, mjedisit dhe sektorit ushqimor. • T'i përgatisë studentët për rolin praktik-shkencor, duke siguruar një bazë të mirë për ata që dëshirojnë të bëhen mësues në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme.

	• T'i ofrojë studentëve njohuri dhe aftësi praktike bashkohore, duke i përgatitur ata për t'u përgjigjur më mirë kërkesave të tregut të punës. • T'i mundësojë studentëve të punojnë në sektorin publik ose privat, duke zgjidhur probleme biologjike, kimike, mjedisore, etj. • T'i përgatisë studentët për të vazhduar studimet në nivelin e dytë [Master] dhe për të fituar rol më të madh në fushën e shkencave të natyrës, mjedisit dhe ushqimit në rajon [Evidenca 1.9, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji - Kimi", Neni 8]. GVJ gjatë vizitës në institucion [takimi me dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit] u njoh në mënyrë të plotë me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, si dhe iu shpjegua se si ky program synon të ofrojë një formim të specializuar dhe të plotësojë nevojat e studentëve në fushën e Biologjisë dhe Kimisë.
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. Përcaktimet vijnë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë," Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave," dhe Vendimit Nr. 185, datë 25.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, 'Për Elementët e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë,' të ndryshuar" [Evidenca II.3, II.3.1, II.3.2, 1.4]. Veprimtaritë formuese janë të grupuara në kategori dhe kanë ngarkesën e tyre në kredite si vijon: • A. Lëndë baze [32,5 kredite] • B. Lëndë karakterizuese [110 kredite] • C. Lëndë Nderdisiplinore/Integruese [24 kredite] • D. Lëndë Plotesuese [8 kredite] Sipas vkm nr. 879, datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të këshillit të ministrave, "për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" kjo kategori lëndësh përfshin 10-15% kredite dmth 18-27 kredite • E. Detyrime Përmbyllese [5,5 kredite] Kjo strukturë e veprimtarive formuese nuk ofron një organizim të qartë dhe të përshtatshëm të programit të studimit, duke mos siguruar një

	shpërndarje të përshtatshme të ngarkesës së studimit në kredite e duhura [Evidenca II.9.1]. <i>Për këtë arsye GVJ rekomandon rishikimin e elementëve të programit mësimor, duke rregulluar përqindjen e krediteve për kategorinë e lëndëve plotësuese, duke u përqëndruar siç përmendëm dhe më sipër në përfshirjen e praktikës profesionale në programin e studimit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	GVB deklaron në raportin e tij [RVB, fq9] se Plan i mwsimor i këtij programi përcakton një zhvillim të detyruar të praktikës profesionale. GVJ konstaton se ky pohim nuk është i mbështetur në evidence. Për më tepër në standartin 1.2, kriteri 3 deklarohet se Institucioni nuk përmban në programin mësimor zhvillim të praktikës profesionale. Në përshtatje me Rregulloren e UGJ [Evidenca 1.2], Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës [Evidenca 1.5], dhe Rregulloren e Programit të Studimit në Biologji - Kimi [Evidenca 1.9], studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor në “Biologji – Kimi” diplomohen duke kaluar provimin përgjithshëm përfundimtar ose duke paraqitur një punim diplomë. Kjo faze përmbyllore përfaqëson 5,5 kredite, që është 3% e numrit total të kredive të programit [Evidenca II.9.1]. <i>Pra, programi ka parashikuar një ngarkesë të përcaktuar në kredite për fazën përmbyllore, por jo për praktikën profesionale, duke ndjekur pjesërisht rregullat dhe udhëzimet.</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Forma e organizimit të studimeve në programin e studimit Bachelor në Biologji “Biologji – Kimi” është studime me kohë të plotë [Evidence 1.4]. Kriteret për pranimin e studentëve dhe specifikat përkatëse janë të përcaktuara në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin. Rregullorja e UGJ dhe Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” përcaktojnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e pranimin, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve [Evidence 1.2; Evidence 1.4; Evidence 1.5; Evidence 1.9]. Financimi i studentëve realizohet përmes bursave dhe përjashtimit nga tarifat e studimit. Financimi ndahet për dy kategori, duke përfshirë studentët me aftësi të veçanta. Procedurat për realizimin e financimit bëhen në fillim të çdo viti akademik, sipas vendimeve të Bordit të Administrimit. [Evidence II.14, II.14.1, II.14.2, II.14.3, II.14.4, II.14.5.] <i>Pra, forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi janë në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, siç është përcaktuar në kriter.</i>
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë	Programi i studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” ka përmbajtje të ngjashme në masën e paktën 70 për qind me programet e studimit Bachelor, të ofruara në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtim në universitetet publike në Shqipëri. Ky konkluzion vjen pas një

përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	analize dhe përfshirjes në grupet e punës për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mesuesisë. Referencat përkatëse, siç janë linket për çdo universitet, janë siguruar për të dëshmuar se programi i studimit në "Biologji – Kimi" është hartuar duke marrë parasysh standardet dhe kërkesat e ngjashme me programet e tjera të ofruara në fushën e studimit të njëjtë. Këto informacione janë sjellë në përputhje me Urdhrin Nr. 225, datë 07.05.2018 të MASR "Për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mesuesisë të institucioneve të arsimit të lartë". Synimi për të ardhmen është që programet e ciklit të parë Bachelor në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtim të përfaqësohen në masën e 80 për qind, duke pasuar udhëzimet dhe synimet e hartuara në kuadër të rishikimit dhe përafrimit të programeve të mesuesisë.
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	DSHBMU, në përputhje me nenin 86 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 310, datë II.5.2022 "Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave, ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Bachelor në "Biologji - Kimi". Propozimi për kodifikimin e programit është dërguar në MASR për aprovim [Evidence 1.22, 1.22.1]. Pas aprovimit nga MASR, programi do të shoqërohet me një kod të përcaktuar sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga Ministria përgjegjëse për arsimin.
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Biologji – Kimi", ka synimin në të ardhmen të hartojë programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe/ose të huaj. Ky synim është në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive me institucione tjera akademike.
Konkluzione	- Programi i studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" organizohet në lëndë e module dhe përfshin elemente të strukturuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve [ECTS]. - Ky program ka një kohëzgjatje normale prej 3 vitesh akademike dhe përbëhet nga një total prej 180 ECTS. Elementet e programit të studimit për "Biologji - Kimi" janë në përputhje të plotë me vendimet ligjore, duke përfshirë ato të Këshillit të Ministrave dhe ndryshimet e tyre. - Programi ka një strukturë të përcaktuar të veprimtarive formuese, të grupuara në kategori të ndryshme si lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, plotësuese dhe detyrime përmbylles.

	- GVJ evidenton se struktura e veprimtarive formuese nuk ofron një organizim të qartë dhe të përshtatshëm të programit të studimit, duke rekomanduar rishikimin e elementëve të programit mësimor. - GVJ ka konstatuar se programi nuk ka përfshirë zhvillimin e praktikës profesionale, duke sjellë në vëmendje një pikë të dobët të programit. Rekomandohet shtimi i praktikës profesionale duke u bazuar në rregulloret dhe udhëzimet e ligjit në fuqi. - Për sa i përket diplomës së studentëve pas përfundimit të studimeve, dokumentet e referuara tregojnë qartë se ata që kryejnë këtë program studimi marrin diplomën "Bachelor në Biologji - Kimi" pas kalimit të provimit përfundimtar ose paraqitjen e një punimi diplomë. - Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit ka shprehur synimin për hartimin e programeve të përbashkëta me institucione tjera të arsimit të lartë, duke përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e njohurive. Programi i studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" ka një strukturë të përcaktuar dhe synon të ofrojë një formim bazë në fushën e Biologjisë dhe Kimisë për studentët. Megjithatë, janë bërë disa rekomandime për rishikim dhe përmirësime në elementët specifike të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe DSHBMU, si njësi bazë e këtij fakulteti, përmbush detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafin akademik, vlerësimin dhe akreditimin [Evidenca 1.1]. Fakulteti i Shkencave të Natyrës është hapur me VKM Nr. 414, datë 12.11.1991 [Evidenca 1.19]. Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit është riorganizuar me vendim të Senatit Akademik, Nr. 31, dt. 19.11.2021 [Evidenca 1.10]. Programi i Studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" është hapur me Vendim Nr. 414, datë 12.11.1991 [Evidenca 1.20]. Plani mësimor është gjithashtu riorganizuar sipas vendimeve të Senatit Akademik: Nr. 16, dt. 23.10.2018, dhe Nr. 17, dt. 08.07.2021. [Evidenca II.7 dhe II.9]. Universiteti i Gjirokastrës ka marrë akreditim periodik institucional me Vendim Nr. 55, dt. 16.12.2021, të lëshuar nga Këshilli i Akreditimit i ASCAL [Evidenca 1.21].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e	Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe DSHBMU, si përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Biologji – Kimi", plotëson detyrimet

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 13

studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

ligjore për planifikim të duhur të mësimi [Ligji Nr. 80/2015 i Arsimit të

	2020-2021	2021-2022	2022-2023
Prof. Dr.	1	1	1
Prof. As.	4	4	4
Dr	2	2	3
MSc	1	1	
PAE	8	8	8
Prof. Dr.	2	1	1
MSc	2	3	5
PAK	4	4	6

Lartë, Neni 25, pika 41].

Per 3 vitet e fundit akademike, stafi akademik i DSHBMU ka kete perberje:

Institucioni eshte ne perputhje me parashikimet ligjore ne lidhje me permbatjen dhe nr e stafit akademik te departamentit.

Organizimi i ndërthurur i programeve studimore është bazuar në strukturën akademike të caktuar nga ligji dhe statuti, duke përfshirë dy personel ndihmës akademik me karakter mësimor për realizimin e punëve laboratorike [Evidenca 1.16, 1.27.1, II.17].

Gjithashtu, plani mësimor për programin e studimit përmban informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve dhe orët e zhvillimit në auditor dhe jashtë auditorit. Kjo është e konfirmuar nga dokumentacioni i rregullorës dhe listat e stafit akademik [Evidenca II.17]. Pra, programi i studimit është i pajisur me planin mësimor, duke përfshirë të gjitha komponentët e nevojshëm për organizim efikas dhe ndjekje të lëndëve në këtë degë studimi. Kjo përputhet me kriterin e përcaktuar.

Kriteri 3. Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe

Në kuadër të programit të studimit Bachelor në “Biologji – Kimi”, njësia kryesore e përgjegjshme, DSHBMU, rolin e koordinatorit për program, e kryen përgjegjësi i departamentit, i cili ka rolin kryesor për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe përmbushjen e objektivave të tij. Ai është përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve në lidhje me programin dhe raportin periodikisht në departament për zhvillimet dhe çështjet e lidhura me programin e studimit [Evidenca II.28, II.28., II.28.2]. Ai ka një rol kyç në sigurimin e koordinimit të përgjithshëm të

praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	programit dhe në sigurimin e përshtatshmërisë së tij me objektivat dhe standardet e përcaktuara. Ky person është pika kryesore e kontaktit për studentët dhe personelin që kanë nevojë për informacione dhe mbështetje në lidhje me programin. Koordinatorit ka përgjegjësi të rëndësishme në sigurimin e ciklit të përditësimit të programit dhe zhvillimit të tij në përputhje me ndryshimet në fushën e studimit dhe kërkesat e tregut të punës. Përmbytja e këtyre detyrave është e vërtetuar përmes dokumentacionit të Veprimtarisë shkencore dhe raporteve periodike, siç paraqiten në evidencat më lartë.			
Konkluzione	<i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit, për programin e studimit Bachelor në "Biologji - Kimi", paraqesin një organizim të rregullt akademik dhe administrativ, duke përmbytur detyrimet ligjore dhe kriteret e akreditimit.</i> <i>Për sa i përket planifikimit të mësimin, programi i studimit është i pajisur me planin mësimor të duhur, duke përfshirë organizimin e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore dhe orët e zhvillimit në auditor dhe jashtë auditorit. Kjo përputhet me detyrimet ligjore dhe standardet e akreditimit.</i> <i>Përgjegjësi i Departamentit luan edhe rolin e koordinatorit të programit, i cili kryen edhe detyrën kryesore për koordinimin dhe zhvillimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbytjes së standardit	Nuk përmbyset	Përmbyset pjesërisht	Përmbyset kryesisht	Përmbyset plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti i Shkencave të Natyrës [FSHN] dhe Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit [DSHBMU], si njesi kryesore/baze për programin e studimit Bachelor në "Biologji – Kimi", disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi. Këto njësi disponojnë: • Rregulloren e DSHBMU [Evidenca 1.7]; • Misionin e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidenca II.18]; • Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidenca 1.9]; • Planin mesimor të programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidence II.9.1]; • Programet [syllabuset] e lëndëve mësimore [Evidence II.30];

	• Modelin e diplomës Bachelor për “Biologji – Kimi” [Evidence II.5]; • Suplementin e diplomës [Evidence II.6.1]; • Strukturën mësimore 2022-2023 [Evidence II.31]; • Listën e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit [Evidence II.32]. Ky informacion tregon se njesia kryesore/baze ka dokumentacionin dhe informacionin e plotë të nevojshëm për të mbështetur organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në “Biologji – Kimi”. Përvoja dhe detajet janë të dokumentuara në mënyrë specifike dhe konkrete me referenca të sakta.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” përmban planin mesimor duke përfshirë informacionin e nevojshëm si më poshtë: • Forma të ndryshme të veprimtarive mësimore [lecione, provime], numri i javëve të kësaj veprimtarie sipas lëndëve, kategorive të ndryshme [leksion, seminar, laborator], dhe numrit total të provimeve sipas semestrave; • Ndarja e lëndëve mesimore sipas viteve dhe semestrave; • Ndarja e lëndëve mesimore sipas aktiviteteve formuese; • Ngarkesa në kredite, numri total i orëve, numri i orëve në auditor dhe jashtë auditorit, si dhe numri i orëve në javë; • Komponentet mësimore për çdo lëndë; • Forma e vlerësimit për secilën lëndë [Evidence II.8, II.9.1]. Përmbajtja dhe struktura e planit mesimor tregojnë se programi është i organizuar dhe disponon informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore, dhe orët në auditor/jashtë auditorit.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” disponon të gjitha informacionet e nevojshme për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Evidencat konkrete që e mbështesin këtë përgjigje janë si vijon: • Rregulloja e Universitetit të Gjirokastrës [UGJ] [Evidence 1.2 Rregullore e UGJ-së, Neni 49, Neni 61, Neni 65]; • Rregulloja e studimeve në UGJ [Evidence 1.4 Rregullore e studimeve në UGJ, Krye VI]; • Rregulloja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës [Evidence 1.5 Rregullore e Njesisë Kryesore FSHN, Krye IV]. Kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të studentëve, si dhe kriteret dhe kuotat e transferimit të studentëve në ciklin e parë të studimit Bachelor në “Biologji – Kimi”, janë propozuar nga Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit [DSHBMU], dhe këto propozime janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, Rregulloren e UGJ-së,

	Statutin e UGJ-së, dhe Udhezimet e MASR [Evidence II.10.1 [Evidence II.11.1, II.12.1, II.13.1, II.20].
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore [syllabuset] për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore [syllabuset] për secilën lëndë, përfshirë praktikant, seminarët, orët laboratorike, si dhe të gjitha komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara dhe syllabuset janë në zbatim të akteve ligjore. Evidencat konkrete që mbështesin këtë përgjigje janë si vijon: • Programet lëndore [syllabuset] për Programin e studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" përmbyllin të gjitha elementet e nevojshme në përputhje me formatin e caktuar në VKM Nr. 41, date 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", • VKM Nr. 879, date 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, date 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", • Vendimi Nr. 185, date 25.3.2021, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, date 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar [Evidence 9.1, II.30].
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Permbajtja e programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm, duke miratuar ndryshimet eventuale në fillim të çdo viti akademik dhe arkivuar dosjen e plotë. Ndër evidencat që e mbështesin këtë përgjigje janë: • Vendimi i Senatit Akademik për riorganizimin e planeve mesimore për vitin akademik 2018-2019 [Evidence II.7], • Vendimi i Senatit Akademik për riorganizimin e planeve mesimore për vitin akademik 2021-2022 [Evidence II.9], • Kthimi i përgjigjes nga MAS për riorganizimin e planeve mesimore [Evidence II.7.2]. Këto evidenca tregojnë se programi ka pësuar ndryshime dhe ka pasuar procesin e përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm, si dhe ka dokumentacionin përkatës që është arkivuar.
Konkluzione	• <i>Fakulteti i Shkencave të Natyrës [FSHN] dhe Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit [DSHBMU] kanë një dokumentacion të plotë dhe të qëndrueshëm për të mbështetur programin e studimit Bachelor në "Biologji - Kimi". Kjo përfshin rregulloren, misionin e programit, rregulloren e programit, planin mesimor, programet e lëndëve, modelin e diplomës, suplementin e diplomës, strukturën mesimore dhe listën e personelit akademik.</i>

	- Dokumentacioni tregon organizim dhe strukturë të qëndrueshme, duke përfshirë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve, ngarkesën mësimore, dhe orët në auditor/jashtë auditorit. - Programi ka procedurat dhe kriteret e qarta për pranimin, transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve, të përcaktuara në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme. Ndërkaq, ndryshimet dhe përmirësimet vazhdojnë të dokumentohen dhe miratohen nga organet akademike. Programi i studimit në “Biologji – Kimi” ka një strukturë të mirëorganizuar dhe një bazë të qëndrueshme dokumentacioni për të mbështetur nevojat e studentëve dhe personelit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënësve dhe vazhdimin e studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Biologji – Kimi” ka emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, dhe shpërndarjen e lëndëve që mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. Përputhur me kriterin, programi është i organizuar dhe strukturuar në mënyrë që të përgatisë studentët në fushën e Biologjisë dhe Kimisë, duke i ndarë lëndët në kategori të ndryshme dhe duke përfshirë lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore/integruese, dhe lëndë plotësuese. Evidencat për këtë janë: - Plani Mesimor për vitin 2021-2022 [Evidenca II.9.1], - Programet Lendore [syllabuset] për vitin 2020-2023 [Evidenca II.30]. Lëndët bazë përfshijnë fusha si Fizika në Biologji, Biologjia Qelizore, Histologjia-Embriologjia, Kimia e Përgjithshme, dhe Anatomia e Njeriut. Lëndët karakterizuese shtrihen nga Zoologjia parazitare deri te Fiziologjia shtazore, duke përfshirë lëndë si Kimia Organike, Mikrobiologjia, dhe Gjenetika. Ndërdisciplinore/integruese përfshijnë fusha si Biostatistika, Ekologjia, Virologjia, etj. Ky program siguron njohuri të specializuara dhe përgatit studentët për aftësi të avancuara në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. Përmirësimi i vazhdueshëm dhe përditësimi është evidentuar në dokumentacionin e disponueshëm. Përfundimi i studimeve ofron formim bazë për vazhdimin e studimeve të larta ose për punësim në fusha specifike si specialist i Biologjisë dhe Kimisë në institucione publike apo private.

Kriteri 2. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Procesi i shpërndarjes së lëndëve dhe moduleve në vitet dhe semestrat e programit Bachelor në Biologji-Kimi në Universitetin “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë është hartuar duke pasuar një qasje të kujdesshme dhe fleksibile. Shpërndarja e lëndëve është bërë duke marrë parasysh objektivat formuese të programit dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Evidencat, siç përfshijnë Planin Mesimor për vitin akademik 2021-2022 [Evidenca II.9.1] dhe syllabuset e programit të studimit Bachelor në “Biologji-Kimi” për periudhën 2020-2023 [Evidenca II.30], tregojnë se lëndët janë organizuar në përputhje me kriterin. Shpërndarja e tyre ka ndjekur një konceptim të qëlluar, duke i dhënë studentëve mundësi të plotësojnë objektivat e tyre mësimore në mënyrë progresive dhe të koordinuar me zhvillimin e tyre akademik. Leksionet, seminarët, dhe laboratorët janë pjesë e strukturës së programit dhe janë vlerësuar në kredite dhe orë mësimore. Ky vlerësim është realizuar duke pasuar një metodologji të përshtatur për të siguruar vështirësinë dhe intensitetin e lëndëve në përputhje me qëllimet e tyre formuese. Në vitin e parë akademik 1500 orë totale janë të ndara në 643.5 orë në auditor dhe 856.5 punë individuale. Në vitin e dytë akademik janë 719.5 orë në auditor dhe 780.5 orë punë individuale, në total 1500 orë dhe në vitin e tretë shpërndarja e orëve është 645 orë në auditor dhe 855 orë individuale, në total sërish 1500 orë. Në vazhdimësi, raportet mbi leksionet, seminarët, dhe laboratorët, si dhe rezultatet e të nxënit, janë përdorur për vlerësimin e dijeve të studentëve [Evidenca II.9.1; Evidenca II.30]. Kjo ka mundësuar një kontroll të vazhdueshëm të përmbushjes së objektivave formuese të programit dhe ka siguruar që rezultatet e pritshme të të nxënit të jenë të arritshme.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Organizimi i programit të studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” në Universitetin “Eqrem Çabej” në Gjirokastrë është kujdesur të jetë në përputhje dhe të përafërt me programe të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare. Ky proces është evidentuar përmes disa dokumenteve zyrtare, përfshirë Planin Mesimor për vitin akademik 2021-2022 [Evidenca II.9.1], syllabuset e programit për periudhën 2020-2023 [Evidenca II.30], si dhe modelin e diplomes dhe suplementin e diplomes [Evidenca II.5 dhe II.6.1]. Struktura e programit, përfshirë lëndët dhe raportin teori-praktikë, është hartuar duke u bazuar në reference të programeve të ngjashme kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe duke u nisur nga sistemi European i Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve [ECTS]. Ky qasje e përshtatshme ka siguruar që programi të ketë një profil të qartë që përputhet me fushën e Shkencave Natyrore dhe të jetë konkurrent me programe të tjera të ngjashme. Kurrikula e programit është organizuar me kujdes, duke siguruar një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, mesatarisht 30 kredite për semestër. Për të rritur aftësitë e studentëve, raporti i orëve është hartuar në mënyrë të balancuar, përfshirë 2 orë leksion dhe 2 orë seminar, ose 2 orë leksion, 1 orë seminar, dhe 1 orë laborator. Kjo ka për qëllim sigurimin e një trajnimit të përshtatshëm dhe të përqendruar në aplikimin praktik të njohurive

	teorike, duke përshtatur programin me profilin dhe synimet e tij. Ngarkesa në kredite për çdo vit akademik është 60 ECTS, një praktikë që përputhet me standarde ndërkombëtare dhe bën programin konkurrues me programe të ngjashme ndërkombëtare. Kjo evidenton përputhjen e programit të studimit me kriterin 3 dhe rëndësinë e harmonizimit me modele ndërkombëtare në fushën e Shkencave Natyrore.
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Natyra e lëndëve dhe ngarkesa e tyre në ECTS është hartuar me kujdes në mënyrë që të sigurojë një integrim të aspekteve teorike dhe praktike, duke e bërë kështu secilën lëndë të jetë në përputhje me objektivat formuese të programit. Kjo përcakton një mjedis mësimor të pasur dhe shumëdimensional, duke lejuar studentët të zhvillojnë njohuri teorike të forta dhe aftësi praktike që mund të aplikohen në situata reale pune. Në vazhdimësi, programi ka qenë i hapur ndaj transferimit të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë, duke siguruar mundësinë për studentët të vijojnë studimet e tyre në Universitetin "Eqrem Çabej" në Gjirokastrë. Kjo është vërtetuar në praktikë dhe është dokumentuar në procedurën zyrtare të transferimit të studentëve [Evidenca II.9.1]. Formimi teoriko-praktik i ofruar nga programi mundëson përgatitjen e studentëve për t'i përgjigjur sfidave të punës në fushën e tyre pas përfundimit të studimeve. Evidencat, përfshirë bazën e të dhënave Alumni dhe analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, konfirmojnë se studentët pas përfundimit të programit kanë arritur sukses në punësim dhe kanë aftësi të zhvilluara teorike dhe praktike [Evidenca II.19 dhe II.23]. Kjo tregon përputhjen e programit me kriterin 4 dhe orientimin e tij drejt përgatitjes së studentëve për tregun e punës.
Kriteri 5. Syllabuset [programet e lëndëve /moduleve] përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Syllabuset e programit të studimit janë përditësuar dhe hartuar në përputhje me shtojcën e Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Këto syllabuse përfshijnë elemente të rëndësishme të lëndës, duke filluar nga pasqyra informative e lëndës, rezultatet e të nxënit, kompetencat e përgjithshme, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, me theks të veçantë në vazhdimësi dhe literaturën [Evidenca II.30]. Hartimi i programeve lëndore organizohet nga një ekip pedagogësh dhe drejtuesit e njesisë bazë, të cilët diskutojnë dhe vlerësojnë ato në Departament. Kjo bën që syllabuset të jenë të përshtatshme për kërkesat e tregut dhe zhvillimin e mësimi. Çdo pedagog depoziton syllabusin e nënshkruar prej tij para fillimit të semestrit, dhe ky dokument është i disponueshëm për studentët përpara fillimit të çdo lënde/moduli. Kjo siguron që studentët të kenë një ide të qartë për strukturën dhe përmbajtjen e lëndës që do të ndjekin. Pjesa e literaturës në syllabus përfshin literaturë bazë detyruese dhe literaturë rekomanduar, duke integruar botime të reja dhe rezultate shkencore. Synimi është që literatura të jetë bashkëkohore dhe të përditësohet për të

	përfshirë zhvillimet e fundit në fushën e studimit [Evidenca II.30 dhe II.22]. <i>GVJ konstaton se me gjithë synimet edhe përpjekjet e bëra literatura ka nevojë për tu përditësuar, pasi rrallë herë është e 5 viteve të fundit dhe rekomandon përditësimin e saj.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit është e organizuar me lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, aktivitete plotësuese dhe detyra përmbyllëse, duke siguruar zhvillimin e përgjithshëm të dijeve, aftësive dhe kompetencave që synohen. Kjo organizim i programit është pasqyruar në çdo program lëndor [syllabus], i cili gjendet në rubrikën "Përmbledhje dhe Rezultatet e të Nxënit". Rezultatet e të nxënit maten përmes realizimit të objektivave të lëndës, të cilat janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj. Këto synime ndahen në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që pritet që studenti të mësojë dhe t'i zhvillojë në përfundim të lëndës. Kjo përcakton një qasje specifike dhe transparente në drejtim të synimeve dhe objektivave të lëndës. Evidencat konkrete që mbështesin këtë kriter përfshijnë Planin Mesimor Bachelor në "Biologji - Kimi" për periudhën 2021-2022, si dhe Programet lëndore [syllabuset] për Programin e Studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" për periudhën 2020-2023 [Evidenca II.9.1 dhe II.30]. Këto dokumente ofrojnë një përmbledhje dhe përcaktim të qartë të objektivave, rezultateve të të nxënit dhe strukturës së programit të studimit.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit siguron një bazë të qëndrueshme dhe të thellë për vijimin e studimeve në nivele të larta akademike, duke përfshirë programet e ciklit të dytë të studimit si "Master në Mësuesi në Biologji — Kimi" pranë UGJ ose Master profesional/shkencor pranë universiteteve të tjera, qofshin ato publike apo private. Evidencat e dhëna nga Lista e fituesve të programeve të ciklit të dytë tregojnë vazhdimësinë dhe përshtatshmërinë e programit Bachelor me programet e niveleve të larta të studimeve. Për studentët që përfundojnë këtë program, ata fitojnë aftësi dhe kompetenca profesionale që i bëjnë të përshtaten për punësim në sektorin publik ose privat. Programi është hartuar duke marrë parasysh kërkesat e tregut të punës, duke siguruar një profil të specializuar në fushat e Biologjisë dhe Kimisë. Evidencat nga Databaza Alumni dhe Informacioni mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ [Evidenca II.19 dhe II.23] ofrojnë dëshmi konkrete se studentët, pas përfundimit të programit, janë të përgatitur për tregun e punës dhe kanë arritur suksese në vijimin e studimeve të tyre ose në zbatimin e njohurive në fushën e Biologjisë dhe Kimisë.
Konkluzione	- Në programin e studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" në Universitetin "Eqrem Çabej" në Gjirokastrë, struktura dhe organizimi janë të përpiluara me kujdes për të përgatitur studentët në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. - Programi ka një strukturë të qëndrueshme dhe fleksibile, duke siguruar një balancim të duhur mes lëndëve teorike dhe praktike. Kjo ka shpërndarje të përshtatshme të orëve mesimore, përfshirë

	leksione, seminare, dhe laboratorë, të cilat janë vlerësuar në kredite ECTS. Ngarkesa në kredite për vit akademik është 60 ECTS, duke u përshtatur standardeve ndërkombëtare. • Programi ka një orientim drejt përgatitjes së studentëve për sfidat e tregut të punës, përfshirë mundësinë e transferimit nga institucione të tjera. • Dokumentacioni zyrtar, përfshirë syllabuset dhe analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave, vërtetojnë që programi është i përshtatshëm me kriteret vendore dhe ndërkombëtare. • GVJ rekomandon përditësimin e literaturës për të qenë e 5 viteve të fundit. • Procesi i vlerësimit të studentëve është transparent dhe ka një metodologji të përshtatshme. • Pas përfundimit të programit, studentët kanë arritur sukses në gjetjen e punës ose vazhdimin e studimeve të tyre në nivele të larta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecursisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Gjatë hartimit dhe ecursisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse janë angazhuar në konsultime dhe kanë marrë parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve dhe aktorëve tjerë nga tregu i punës [Evidenca II.15, II.15.1]. Politikat e zhvillimit të Departamentit të Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit [DSHBMU] rrjedhin nga politikat e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej", të cilat janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës [Evidenca II.33]. Kjo ka për qëllim përmirësimin e kurrikulave mësimore dhe sigurimin e një oferte të përshtatshme për studentët në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Përmbajtja e programeve lëndore është hartuar në koherencë me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri, duke siguruar zhvillimin e njohurive të reja dhe kompetencave. Kjo përshtatje ka bërë që studentët në programin e Biologji-Kimi të zhvillojnë kompetenca të nivelit të lartë, të përshtatshme me nevojat dhe interesat e tyre, duke pasur parasysh edhe marrëdhëniet e tyre të ardhshme me tregun e punës dhe zhvillimet teknologjike [Evidenca II.15, II.15.1]. Për të përmirësuar ende më tej përmbajtjen dhe ecurinë e programeve të studimit, institucioni është përfshirë në këshillim dhe promovim nëpër evente të ndryshme, duke bashkëpunuar me praktikanët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës. Përvojat dhe njohuritë e përfituara nga pjesëmarrja në panairin "Work and Study" janë dëshmi konkrete e këtij

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 22

	angazhimi dhe kontributi në përmirësimin e programit të studimit [Evidenca II.15, II.15.1]. Gjithashtu, eksperiencat, njohuritë dhe aftësitë e përfituara nëpërmjet trajnimeve dhe pjesëmarrjeve në projekte nga personeli akademik synojnë në përmirësimin e përmbajtjes dhe ecurisë së programeve të studimit.
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë të përfshirë në Senatin Akademik të UGJ [Evidenca II.1.1], janë të organizuar në Këshillin Studentor të UGJ [Evidenca II.26] dhe kanë statutin e tyre të funksionimit [Evidenca II.25]. Përveç kësaj, Universiteti mbart kontakte të vazhdueshme dhe konsultohet me studentët e diplomuar përmes Zyres së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni. Kjo bashkëpunim ka një qëllim të qartë, të sigurojë një rikthim konstant të informacioneve dhe eksperiencave të diplomuarve për të përmirësuar dhe përditësuar programin e studimit [Evidenca II.23]. Ky dialog ndihmon në reflektimin mbi përmbajtjen dhe zhvillimin e programit të studimit, duke siguruar që të përgjigjet ndaj nevojave dhe pritshmërive të studentëve të tanishëm dhe atyre të ardhshëm.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale [veçanërisht në fushën e mjekësisë] dhe institucione publike e private.	Departamenti të Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit [DSHBMU], në përmirësimin dhe përditësimin e programit të studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fushat e ndryshme. DSHBMU ka përcjellë një qasje të përshtatshme për sigurimin e literaturës bashkëkohore dhe të fundit. Ky proces përfshin konsultime të vazhdueshme me bibliotekën e UGJ, e cila ka një koleksion të pasur të librave dhe literaturës shkencore, duke përfshirë abonim në revista shkencore ndërkombëtare për të qenë në vazhdimësi të informuar mbi zhvillimet më të reja në fushën e studimit. [Evidenca II.30]. Kjo bashkëpunim me burimet e bibliotekës dhe përdorimi i literaturës bashkëkohore shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për përmirësimin e programit të studimit, duke siguruar që materialet mësimore të jenë të përditësuara dhe të përshtatshme me zhvillimet më të fundit në fushën e Biologjisë dhe Kimisë.
Konkluzione	- Në hartimin dhe zhvillimin e programit të studimit, njësitë përgjegjëse janë përfshirë në konsultime aktive, duke marrë parasysh propozimet e institucioneve partnerë, diplomuarve, dhe aktorëve të tregut të punës. - Programi është hartuar duke u përpjekur për koherencë me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Shqipëri, duke siguruar që studentët të zhvillojnë njohuri dhe kompetenca të nivelit të lartë. - Përmbajtja e programeve është përmirësuar nga eksperiencia në panairin "Work and Study" dhe trajnimet, duke pasur parasysh nevojat e studentëve dhe zhvillimet teknologjike. - Studentët janë të përfshirë në organet vendimmarrëse të universitetit dhe kanë kontakte të vazhdueshme me Zyren e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni për të ndarë eksperiencat dhe informacionet e tyre.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e përdorura janë të ndryshme dhe të miratuara nga institucioni dhe përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, aktivitete praktikore, orët e hapura dhe çdo formë tjetër të aprovuar nga institucioni. Rregullorja e studimeve në UGJ dhe Rregullorja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Mjedisit përcaktojnë këto formate të mësimdhënies [Evidenca 1.4, 1.2]. Këto informacione janë shprehur edhe në planin mësimor të programit Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidenca 11.9.1] dhe në Programet lëndore [syllabuset] të programit të studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" [Evidenca 11.30]. <i>E rëndësishme është të theksohet se, sipas informacioneve, DSHBMU nuk ka përfshirë praktikën profesionale në programin e studimit Bachelor në "Biologji – Kimi".</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i programit ka përshtatur mësimdhënien në përputhje me nevojat e studentëve, përdorur metoda alternative, dhe ka integruar teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie. Kjo është e përputhur me Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidenca 1.9 6]. Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, personeli akademik ka përdorur metoda didaktike tradicionale dhe innovative, duke integruar teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie [Evidenca III.5, III.5.1]. Kjo përfshirë mësimdhënie online përmes platformave të mësimin në distancë si Classroom, Edumeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams, veprimtari që u shtri në periudhën e pandemisë Covid-19 [Evidenca III.1, III.1.1, III.1.2, III.1.3, III.1.4, III.1.5, III.1.6, III.1.7, III.1.8, III.1.9, III.1.10]. Në të njëjtën kohë, programi i studimit ka përfshirë veprimtaritë formuese "Lëndë me zgjedhje" në planin mësimor, duke lejuar studentët të zgjedhin sipas interesit dhe nevojave të tyre [Evidenca II.9.]. Këto hapa tregojnë përkushtim të institucionit për përmirësimin e mësimdhënies dhe përshtatjen ndaj nevojave të studentëve.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Institucioni ka ndërmarrë disa hapa për të siguruar përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit akademik dhe për të përshtatur mësimdhënien me rezultatet e pritshme të të nxënit. Këto hapa përfshijnë: - Infrastrukturë e mësimdhënies: Ofrimi i auditorëve të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies [Evidenca 111.2]. Modernizimi i bazës laboratorike dhe mbajtja e saj në

	gatishmëri për aspekte praktike të procesit mësimor [Evidenca 111.3]. - Zhvillim i kapaciteteve të personelit akademik: Krijimi i oportuniteteve për stafin akademik për zhvillimin e kapaciteteve didaktike dhe kerkimore shkencore përmes mobiliteteve në institucione të tjera të kushtimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, si dhe pjesëmarrjeve në trajnime dhe ëorkshope [Evidenca 1.25, 1.24]. Hartimi i udhëzuesve për përdorimin e metodave të udhëzimit inovative të mësimdhënies [Evidenca 111.5, 111.5.1, 111.1.4, 111.5.3, 111.5.4]. - Përdorim i burimeve elektronike: Përdorimi i librave elektronike për të përmirësuar aksesin dhe përdorimin e burimeve të shkencës [Evidenca 111.]. - Projekte ndërkombëtare dhe bashkëpunime: Pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare si TEAVET dhe TeComp për të përmirësuar kompetencat didaktike përmes koordinimit ndërinstitucional dhe trajnimeve [Evidenca 1.25 dhe 1.24]. Gjithashtu, gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, UGJ ka organizuar trajnime për personelin akademik mbi përdorimin e platformave të mësimimit në distancë për të siguruar një mësimdhënie sa më efektive [Evidenca 111.1.]. Përmes këtyre veprimeve, institucioni ka theksuar angazhimin për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe përputhjen me nevojat dhe pritshmëritë e studentëve.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Programi i Studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” përmbush kriterin e personelit akademik duke siguruar një staf të kualifikuar dhe kompetent për mësimdhënie. Sipas dokumentacionit dhe anekseve të paraqitura, për vitin akademik 2022-2023 programi studimit ka 8 anëtarë personel akademik efektiv [PAE], 6 anëtarë personel akademik me kontratë [PAK], dhe 2 personel ndihmës akademik, të përbërë nga profesorë, profesorë të asociuar, lektorë, dhe mjeshtër të shkencave. Stafi akademik është i kualifikuar në nivelin e duhur, duke përfshirë personel me titujt "Profesor", "Profesor i Asociuar", "Lektor me Doktoratë", dhe "Master i Shkencave". Përmbushja e kualifikimeve akademike të personelit është evidencuar në CV-të e tyre [Evidenca III.4]. Metodat e mësimdhënies janë të përshtatshme dhe përfshijnë leksione të shoqëruara me prezantime multimediale, seminare interaktive për zgjidhjen e ushtrimeve, dhe punë laboratorike për thellimin e aftësive eksperimentale të studentëve. Stafi akademik siguron mbështetje të vazhdueshme, konsultime, dhe ndërtimin e një marrëdhënie të respektit me studentët. Metodat e vlerësimit përdorin pyetësore dhe rezultatet e tyre tregojnë se mbi 85% e studentëve konfirmojnë vlerësimin pozitiv për aftësitë dhe kompetencat e stafit akademik. Avancimi i stafit akademik është shfaqur në aktivitetin kërkimor shkencor në fushën e

	tyre [Evidenca III.6 Pyetësor Studentor]. Ky vlerësim tregon se programi përmbush kriterin 4 duke siguruar një staf akademik kompetent dhe të përgatitur për të shpjeguar njohuritë dhe konceptet dhe për të krijuar një mjedis mësimor interaktiv dhe mbështetës për studentët.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Programi i Studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” përmbush kriterin 5 duke dëshmuar se njësia përgjegjëse për ofrimin e programit ka një qasje periodike për të vlerësuar dhe përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies. Kjo ka të bëjë me përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit dhe marrjen parasysh të mendimeve dhe sugjerimeve të tyre [Takimi me stafin akademik, takimi me studentët]. Sipas Raportit të Vlerësimit të Brendshëm [RVB], personeli akademik i DSHBMU-së ka zbatuar një qasje periodike përmes pyetësoreve me studentë për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies. Ky proces përfshin analizën e vlerësimeve, mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkekohore mesimdhënëse, si dhe vlerësimit të përgjithshëm. Ka evidenca që tregojnë procedurë për organizimin e pyetësorit studentor, si dhe vetë përbërjen e pyetësorit. <i>Megjithatë, në takimin e GVJ me përfaqësuesit e sektorit të standarteve, cilësisë dhe kurrikulave, u bë e ditur se nuk ka një vlerësim të veçantë për pyetësoret. Kjo mungesë analize është një pikë e dobët e identifikuar nga ana e GVJ-së, dhe GVJ propozon një analizë më të thelluar të pyetësoreve të studentëve dhe përdorimin e tyre për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies në të ardhmen</i> [Takimi me përfaqësuesit e sektorit të standarteve, cilësisë dhe kurrikulave].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të	Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit Studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ka një qasje periodike për të vlerësuar dhe përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies [Takimi me stafin akademik, takimi me studentët]. Sipas Statutit të UGJ-së [Evidence I.1], njësitë ndihmëse për procesin mesimor-kerkimor janë pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike dhe Administrative. Këto njësi përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies dhe trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja [Evidence III.5, III.5.1]. Evidencat tregojnë se Universiteti ka revistën shkencore "Kerkime Universitare" [Evidence III.14], që reflekton botimet më të fundit të institucionit. Gjithashtu, është themeluar Qendra e Mësuarit gjatë Gjithë

mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Jetës [LLL Centre], e cila koordonon trajnimet dhe shfrytëzon pajisjet dixhitale për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies [Evidence I.14].			
Konkluzione	- Programi përdor një gamë të gjerë formash mësimore, duke përfshirë leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, aktivitete praktikore, dhe orë të hapura.. - Një element i identifikuar nga analiza është mungesa e praktikës profesionale në programin e studimit Bachelor në "Biologji – Kimi - Për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, personeli akademik ka përdorur metoda didaktike tradicionale dhe innovative, duke integruar teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Përdorimi i platformave të mësimin në distancë ka qenë i rëndësishëm, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. - Programi ka integruar veprimtaritë formuese "Lëndë me zgjedhje" në planin mësimor, duke lejuar studentët të zgjedhin sipas interesit dhe nevojave të tyre. - Personeli akademik ka pasuar një qasje të përshtatshme, ka integruar teknologji në mësimdhënie, dhe është përgatitur për shpërndarjen e njohurive. - Institucioni ka ndërmarrë hapa për të siguruar përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit akademik përmes trajnimeve, mobiliteteve, krijimit të udhëzuesve, dhe përdorimit të burimeve elektronike. - Përdorimi i librarive elektronike dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare tregojnë për përdorimin e burimeve të shkencës dhe bashkëpunimin ndërkombëtar për përmirësimin e programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Për Programin e Studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, kriteret dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në disa dokumente zyrtare, duke përfshirë: - Rregulloren e UGJ: Nenet 68, 81, 82, 83 [Evidence I.2] - Rregulloren e studimeve ne UGJ: Nenet 39, 40, 41, 62, 63, 64 [Evidence I.4]; - Rregulloren e FSHN-se: Nenet 33, 34, 35, 38 [Evidence I.5]; - Rregulloren e DSHBMU-se: Nenet 28, 30, 31 [Evidence I.7];

	• Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" Nenit 18, 19, 20, 21, 22, 23 [Evidence I.9]; • Programet Lendore: [Evidence II.30]. Gjithashtu, udhezimet institucionale [Evidence III.12, III.8] përdoren për të saktësuar procesin e testimit dhe vlerësimit. Këto dokumente janë bërë publike për të siguruar një transparencë të plotë dhe studentët janë të njohur me to. [Takimi me studentët]
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Sipas Rregullores së Studimeve në UGJ, pikat 4 dhe 5 të Nenit 39 [Evidenca I.4], modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit bëhen të njohura studentëve në fillim të procesit mësimor dhe janë të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës [Evidenca II.30]. Këtë e konfirmuan edhe studentët në takimin që GVJ pati me ta [Takimi me studentët]. Kjo siguron që studentët të kenë informacion të qartë dhe të plotë në lidhje me metodologjinë dhe kriteret e vlerësimit që do të aplikohen në kuadër të secilit lëndë/moduli.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Rregullorea e UGJ, Rregullorea e Studimeve në UGJ, Rregullorea e FSHN, Rregullorea e DSHBMU dhe Rregullorea e programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidencat: I.2, I.4, I.5, I.7, I.9] përcaktojnë format e vlerësimit të studentëve. Përshkrimi i detajuar i këtyre metodave dhe kriterëve gjendet në këto dokumente ligjore. Vlerësimi i studentëve është i ndarë në dy pjesë: vlerësimin e vazhduar dhe provimin final. Vlerësimi i vazhduar përfshin 20% të vlerësimit përfundimtar dhe është bazuar në detyrimet e përcaktuara në programin e lëndës [Evidenca: I.4, II.30]. Provimi final zhvillohet në formën e një provimi me shkrim, përfshirë pyetje teorike ose ushtrime/probleme logjike. Numri i pyetjeve dhe vështirësia e tyre varet nga vëllimi i lëndës dhe materiali i përcjellë në leksione dhe seminare. Përgjigjet e studentëve vlerësohen në total me 80 pikë dhe përfshijnë pyetje të formuluar qartë, kërkesë që inkurajojnë vetëvlerësimin nga ana e studentit [Evidenca: II.12, I.4, II.30].
Kriteri 4. Njësia bazë/ Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Në RVB pohohet se personeli akademik i Njesisë Bazë për programin e studimit "Biologji-Kimi" vlerëson dhe përmirëson periodikisht format dhe metodat e mësimdhënies. Ky proces përfshin pjesëmarrjen e studentëve, duke u angazhuar në pyetësore për vlerësim, ku opinionet dhe sugjerimet e tyre janë të rëndësishme për të pasur një përmirësim të qëndrueshëm. Gjithashtu pohohet se në këtë mënyrë periodike, NJSBC-ja kryen pyetësore me studentët për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies. Rezultatet e këtyre pyetësoreve përdoren për të zhvilluar dhe përmirësuar format e mësimdhënies, trajtimin e lëndës, përdorimin e metodave mësimore, dhe procesin e vlerësimit. Opinionet dhe sugjerimet e studentëve marrin një rol kyç në procesin e vendimmarrjes për të përmirësuar aspektet e ndryshme të programit dhe për të siguruar

	një përvojë mësimore sa më të përshtatshme për ta [Evidencat: III.6, II.23, III.7]. <i>Megjithatë evidencat e vëna në dispozicion tregojnë vetëm një vlerësim të mësimi të zhvilluar online. Përsërisim që e konstatuam dhe më sipër në standartin III.1 kriteri 6, mungesën e analizës së pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e procesit mësimor.</i>
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, kriteri 5 përmbushet në mënyrë efektive, duke përmirësuar mësimdhënien dhe duke inkurajuar përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksibile pedagogjike. Kjo është e arritur nëpërmjet disa hapa dhe iniciativave: • Përmirësimi i infrastrukturës së mesimdhënies: Duke furnizuar auditorë të pajisur me teknologji bashkëkohore të mesimdhënies në laboratorët e ndryshëm, duke përfshirë Laboratorin e Zoologjisë, Laboratorin e Fiziologjisë Shtazore, Laboratorin e Kimisë Organike, dhe të tjerat [Evidenca III.2..] • Modernizimi i bazes laboratorike: kjo ka qenë një fokus për sigurimin e mjeteve laboratorike dhe mbajtjen e tyre në gjendje optimale për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor [Evidenca III.3.]. • Zhvillimi i kapaciteteve didaktike dhe shkencore të stafit akademik: Duke krijuar mundësi për stafin akademik për të zhvilluar kapacitetet e tyre didaktike dhe shkencore përmes mobiliteteve në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit dhe përfshirjes në trajnime dhe ëorkshope në kuadër të projekteve me partnerë të huaj [Evidenca I.25, I.24]. • Hartimi i udhëzuesve për metodat e ndryshme inovative të mësimdhënies: Përmes udhëzuesve institucionalë dhe strategjive si TECOMP, është inkurajuar përdorimi i metodave inovative [Evidenca III.5, III.5.1]. • Përdorimi i librave elektronik: Nëpërmjet informacionit për bibliotekën U-Library, është inkurajuar përdorimi i librave elektronik [Evidenca III.9]. • Fokusimi në angazhimin e studentëve: Në programin lendor të secilës lëndë, janë përdorur format dhe metodat e mësimdhënies që inkurajojnë autonomi të studentëve [Evidenca II.30]. • Mbrojtja e Procesit Mësimor gjatë Pandemisë: Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, është bërë përdorimi i platformave elektronike për mësim në distancë, duke siguruar udhëzime dhe resurse për studentët dhe stafin akademik [Evidenca III.1, III.1.1, III.1.2, III.1.3, III.1.4, III.1.5]. Përmbushja e këtij kriteri është e vërtetuar nga evidencat dhe hapat konkrete të ndërmarrë nga institucioni për të përmbushur objektivat e tij për mësimdhënie cilësore dhe të përshtatshme për studentët.

Konkluzione	- Analiza e Programit Bachelor në "Biologji - Kimi" në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër fokusohet në kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive të studentëve.. - Procesi i vlerësimit përfshin dy pjesë: vlerësimin e vazhduar [20% të vlerësimit përfundimtar] dhe provimin final, i zhvilluar në formën e një provimi me shkrim. - Studentët janë të informuar në fillim të procesit mësimor për metodat dhe kriteret e vlerësimit që do të aplikohen. - Iniciativat dhe hapat për përmirësimin e mësimdhënies janë të shumëllojshme, përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së mesimdhënies, modernizimin e bazës laboratorike, zhvillimin e kapaciteteve didaktike të personelit akademik, dhe përdorimin e metodave inovative dhe teknologjive. - Procesi i vlerësimit përfshin një pjesëmarrje aktive të studentëve përmes pyetësoreve dhe analizës së vlerësimeve për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Megjithatë, GVJ konstatoi se në institucion mungon analiza e pyetësorëve të studentëve mbi vlerësimin e procesit mësimor			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, ka ndjekur një procedurë të strukturuar, duke përfshirë hapa të rëndësishëm dhe procedura specifike. Evidencat e paraqitura nga Rregullorja e FSHN-së dhe Rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" [Evidenca I.5, I.9] dhe Rregullorja e studimeve në UGJ [Evidenca I.4] japin strukturën dhe modalitetet e përdorura për testimin dhe vlerësimin e studentëve. Procesi i vlerësimit përfshin hapa të ndryshëm: Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit: Ky aspekt vlerësohet gjatë gjithë vitit akademik dhe përfshin elementet e programit të lëndës, duke përbërë 20% të vlerësimit përfundimtar. Provimi përfundimtar: Përfshin një provim që kryhet në fund të periudhës së mësimdhënies dhe përbën 80% të vlerësimit përfundimtar. Për kontrollin me shkrim, përdoret një sistem pikësh, ndërsa për detyrat me vlerësim në pike, konvertimi nga nota është i mundur. Komunikimi i rezultateve të studentëve: Në fund të çdo periudhe mësimore, pedagogu informon studentët për fitimin



	ose mungesën e së drejtës për të futur në provim, si dhe rezultatin e vlerësimit të vazhduar. Llogaritja e vlerësimit përfundimtar bëhet në përputhje me Rregulloren e Universitetit [Evidenca I.2.] Përputhja e këtyre praktikave me rregullat dhe procedurat zyrtare tregon një zbatim të përpiktë dhe transparent të procesit të testimit dhe vlerësimit në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ka implementuar një sistem elektronik të testimit dhe vlerësimit që ka ndihmuar në shmangien e formave të ndryshme të abuzimit dhe ka rritur transparencën në procesin e vlerësimit. Kjo ka ndodhur përmes përdorimit të një sistemi të automatizuar të korigjimit të provimeve, i cili është zbatuar në kuadër të projektit CLEANSCORE, financuar nga AADF [Fondacioni për Zhvillim të Arsimit në Shqipëri]. Studentët janë të njohur me metodologjinë e zhvillimit të provimeve gjatë procesit mësimor, dhe ata kanë njohuri rreth mënyrës së vlerësimit të tyre. Për të siguruar kualitet dhe transparencë, personeli akademik është asistuar nga një koordinator i AADF pranë Universitetit të Gjirokastrës për korigjimin e provimeve me këtë sistem elektronik [Evidenca III.8]. Në periudhën e pandemisë së COVID-19, gjatë kohës së mësimin në distancë ["online"], UGJ ka implementuar testimin përmes platformës elektronike Microsoft Teams. Kjo ka siguruar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm për vlerësimin e studentëve. Kjo praktikë është implementuar edhe në programin Bachelor në “Biologji – Kimi” dhe ka përfshirë trajnime për personelin akademik në hartimin e tezës elektronike të provimit, prezantimin e rezultateve, planifikimin e orarit të provimit online, dhe të tjera [Evidenca III.1.7, III.1.8, III.1.9]. Këto hapa kanë siguruar që vlerësimi i studentëve të kryhet me sukses dhe me transparencë të plotë.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar i lëndës në UGJ është në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca I.4] dhe në programin e lëndës [Evidenca II.30], vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga dy komponentë: • Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit: Ky pjesë e vlerësimit përfshin elementet e përcaktuara në programin e lëndës dhe përbën 20% të vlerësimit përfundimtar. • Vlerësimi në provim: Ky komponent përbën 80% të vlerësimit përfundimtar dhe është rezultat i provimit të zhvilluar në fund të procesit mësimor. Pedagogu, në përputhje me Rregulloren e UGJ [Evidenca I.2], informon studentët pas përfundimit të procesit mësimor në lidhje me:

	• Drejtën për të futur në provimin e lëndës perkatese: Nëse studenti ka të drejtën për të futur në provimin e lëndës, kjo i komunikohet drejtpërdrejt studentit. • Rezultatin e vlerësimit të vazhduar: Pedagogu informon studentët për rezultatin e vlerësimit të tyre të vazhduar. Llogaritja e vlerësimit përfundimtar bëhet në përputhje me përcaktime në Rregulloren e Universitetit [Evidenca 1.2]. Kjo procedurë siguron një proces vlerësimi të rregullt dhe transparent për studentët, duke i lejuar ata të dinë dhe të kuptojnë rezultatin e tyre në mënyrë të qartë dhe të drejtë.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback [nëse është i nevojshëm] dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	UGJ implementon një proces vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale që shoqërohet me komente dhe feedback për të ndihmuar studentët të përmirësohen në të ardhmen. Procesi i vlerësimit përfshin fazat e ndryshme të kontrollit gjatë semestrit, duke përfshirë teste, provime të ndërmjetme, punë laboratorit, detyra kursi, dhe provim final. Korrigjimi i provimeve me shkrim kryhet nga komisioni i provimit. Studentët informohen për rezultatet paraprake të provimit përmes publikimit online në librezën e tyre elektronike në sistemin ESSE3 ose në sistemin Pitagora, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të provimit [Evidenca 1.2]. Pas shpalljes së rezultateve, studentët kanë të drejtën të rishikojnë individualisht tezat e tyre të korrigjuara nga pedagogu. Ky proces rishikimi përfshin vlerësimin për çdo përgjigje, të shoqëruar nga komente, feedback dhe këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Rregullorja e studimeve në UGJ [Evidenca 1.4] siguron të drejtën e studentëve për të paraqitur anketa në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut. Pedagogu, në përputhje me procedurat, gjeneron, publikon online dhe dorëzon në Sekretarinë Mesimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit brenda 8 ditëve nga data e zhvillimit të provimit, kur nuk ka proces ankimi nga studenti. Ky proces siguron transparencë dhe mundëson rishikimin dhe vlerësimin e punës së studentëve.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Personeli akademik i DSHBMU-se ndjek rregulla të rrepta për të parandaluar çdo formë të plagjiaturës, duke përfshirë kopjimin në provime dhe detyra për studentët që janë pjesë e programit të studimit. Ata aplikojnë dhe zbatojnë rregullat e provimeve të përcaktuara në rregulloren e studimeve në UGJ [Evidenca 1.4], në Rregulloren e UGJ-se [Evidenca 1.2], në Kodin e Etikës [Evidenca III.10], dhe në syllabuset e çdo lënde me anë të komenteve përfundimtare nga pedagogu i lëndës. Studentët janë të detyruar të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër gjatë gjithë kohës që gëzojnë statusin e studentit në këtë universitet. Këto dispozita përfshijnë sjelljen e tyre gjatë procesit mësimor, duke përfshirë moskopjimin, mosmashttrimin dhe ndalon plagjiaturat në çdo formë, etj., të përcaktuara në Kodin e Etikës [Evidenca III.10]. Kjo përcaktim është një shenjë e

	përkushtimit të institucionit ndaj integritetit akademik dhe promovimit të sjelljes etike në kuadër të mësimdhënies dhe vlerësimit.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	UGJ u garanton studentëve vlerësimin e dijeve dhe aftësive profesionale që bazohet në meritë, siç është përcaktuar në Kodi i Etikës [Evidenca III.10]. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë, duke u bazuar në rregulloret përkatëse. Vlerësimi perfundimtar përbëhet nga vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar i jepet studentëve në përfundim të procesit mësimor, sipas Rregullores së Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 81, pikat 11. Provimi, i bazuar në Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 83, pikat 1, 2, përmban pyetje që trajtojnë lëndën në mënyrë të plotë dhe për çdo pyetje/ushtrim përcaktohen pikët përkatëse. Zhvillimi i provimit mbahet me sekret, dhe përgjegjës për sekretizimin e fletoreve është personi i përgjegjshëm i departamentit ose një person i mësuar i cili nuk është pjesë e komisionit [Evidenca 1.5]. Rezultatet e vlerësimit perfundimtar jepen në kohë duke u bazuar në procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, Neni 90, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Neni 34, pika 16, dhe në Rregulloren e DSHBMU-se [Evidenca 1.7]. Kjo siguron që studentët të kenë akses të drejtë dhe në kohë të rezultateve të tyre akademike.
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin dhe për të kërkuar rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. Studentët në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë gëzojnë të drejtën për të njohur me vlerësimin e dijeve dhe për të kërkuar rishikim të vlerësimit për të gjitha format e kontrollit të dijes të përcaktuara në syllabusin e lëndës, para se ky vlerësim të marrë formën perfundimtare. Në raste paqartësish, ata kanë të drejtë të rishikojnë personalisht tezën e korrigjuar në prani të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e nevojshme [Evidenca 1.2, 1.4]. Kjo siguron transparencë dhe drejtësi në procesin e vlerësimit për studentët.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo kërkesë ose ankimim lidhur me saktësinë dhe korrektesinë e vlerësimit të dijeve, përmes të gjitha formave të kontrollit, të bëra të pranishme nga studentët, është plotësisht parashikuar në Rregulloren e Studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë [Evidenca 1.4.] Kërkesa apo ankesa duhet të paraqitet me shkrim brenda afatit të caktuar për ankimim dhe drejtohet Dekanit të Fakultetit. Dekani përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në rast se zbulohen praktika që bien ndesh me rregulloren, atëherë, me propozim të Përgjegjës të Departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënia e provimit [Evidenca 1.4]. Procedurat e ndjekura në këtë proces duhet të jenë transparente për



	të gjitha palët e përfshira, dokumentohen dhe arkivohen për të siguruar një trajtim të drejtë dhe transparent të çdo kërkesë ose ankimi.			
Konkluzione	- Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka ndjekur një procedurë të strukturuar dhe transparente për testimin dhe vlerësimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në "Biologji - Kimi". Procesi i vlerësimit përfshin vlerësimin e vazhduar dhe provimin përfundimtar, duke përdorur një sistem pikësh. Rezultatet dhe feedback-u jepen studentëve në kohë dhe përmes platformave online. - Institucioni ka implementuar një sistem elektronik të testimit dhe vlerësimit, duke përdorur një sistem të automatizuar të korrigjimit të provimeve, duke garantuar transparencë dhe shmangien e abuzimeve. - Procesi i vlerësimit përmbush kriteret dhe modalitetet e përcaktuara në rregulloret zyrtare të universitetit, duke siguruar një vlerësim të rregullt dhe transparent. Studentët njihen me metodologjinë e vlerësimit dhe kanë mundësi të rishikojnë tezat e tyre të korrigjuara për të kuptuar më mirë rezultatin dhe për të marrë feedback. - Procedurat për ankesa dhe rishikime të vlerësimit janë përcaktuar në rregulloret dhe statutet e universitetit. Studentët kanë të drejtën për të paraqitur ankesa dhe kërkesa për rishikim brenda afateve të përcaktuara, dhe procedurat janë transparente dhe dokumentohen për të siguruar një trajtim të drejtë dhe transparent për çdo kërkesë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" është i organizuar në mënyrë të kujdesshme për të siguruar thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. Organizimi i programit është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", si dhe me ndryshimet dhe shtesat e mëtejshme në këtë vendim [Evidenca 11.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca 11.3.1 VKM Nr. 879, datë 18.12.2019; Evidenca 11.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021]. 1. Lëndët bazë të programit përfshijnë degën e Biologjisë dhe Kimisë dhe përfshijnë lëndë të tilla si Biologjia e qelizës, Histologjia, Anatomia e njeriut, Kimia e përgjithshme, etj.

	2. Lëndë karakterizuese përfshijnë Zoologjinë pararruazore, Botanikën e përgjithshme, Kiminë inorganike, Kiminë analitike, Zoologjinë vertebralore, Sistematikën bimore, Kiminë organike, Kiminë biologjike, Fiziologjinë bimore, etj. 3. Lëndët ndërdisiplinore dhe/ose integruese përfshijnë Litosferën, Biogeografinë, Ekologjinë, Teorinë e evolucionit, Fizikën, etj. 4. Teknologjia e informacionit është gjithashtu pjesë e programit me një lëndë të posaçme me 8 kredite. 5. Pjesa e detyrimeve përfshin punimin në përfitim të aftësive në thellësi të njohurive të huaja dhe lënda e Informatikës me 8 kredite. 6. Detyrime permbylëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose provimit të përgjithshëm perfundimtar, përbëjnë 5.5 kredite. 7. Veprimtaritë formuese përfshijnë komponente mesimore të ndara në mësim në auditor [leksione, seminare, ushtrime, laboratorë] dhe studim individual [studim, punë me literaturë, detyra apo projekte, përgatitje provimesh, etj.]. Kjo strukturë programi e bën të mundur zhvillimin e plotë të njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve, duke ofruar një gamë të gjerë lëndësh dhe veprimtarish formuese. [Evidenca 11.9.1, 11.30]. <i>GVJ e konsideron si pike të dobët mungesën e praktikës profesionale e cila do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” është i përgatitur që të sigurojë zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve, veçanërisht në fushën e biologjisë, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit, si dhe të kimisë së mjedisit. Natyra e programit e bën të mundur të ofrojë një përfaqje të veçantë ndaj fushave të studimit, duke përfshirë biologjinë dhe kiminë mjedisore. Gjatë vitit të parë të studimeve, gjuha e huaj përfshihet në program, duke ndihmuar studentët në përdorimin e literaturës në gjuhë të huaja dhe duke i lehtësuar ata për të shfrytëzuar burimet e informacionit në fushën e studimit në nivel ndërkombëtar. Përmes lëndës së zgjedhjes “Shkrim dhe Menaxhim Projektsh”, studentët zhvillojnë aftësi të menaxhimit, komunikimit, dhe ndërveprimit të punës në grup. Kjo lëndë siguron një perspektivë më të gjerë mbi aftësitë që mund të përdoren në fushat e shkencave natyrore dhe kimisë mjedisore, duke përfshirë njohuri në menaxhimin e projekteve dhe komunikimin efektiv [Evidenca 11.9.1; 11.30].



Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Programi i studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” siguron hartimin dhe analizimin e programeve lendore nën drejtimin e departamentit dhe drejtësit të tij, sipas Rregullores së Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër [Evidenca I.2]. Syllabuset e secilës lëndë të programit mesimor për “Biologji – Kimi” përfshijnë informata në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe rezultatet e pritura që studenti do të marrë në përfundim të lëndës [Evidenca II.30]. Gjatë gjithë procesit mesimor dhe veçanërisht në përfundim të çdo lënde, personeli akademik fokusohet në çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. Në përfundim të çdo semestri akademik, personeli akademik ofron orë të veçanta konsultimi, duke përfshirë orientimin e studentëve në çështjet kyçe dhe përgjigjen e pyetjeve të tyre mbi lëndën perkatese [Evidenca III.1.11]. Rezultatet e studentëve, përfshirë kompetencat dhe aftësitë që ata fitojnë, evidentohen në vlerësimet e tyre gjatë vitit, përfshirë notat në vlerësimin e vazhduar dhe në provimet përfundimtare. Ky proces ofron një pasqyrë të qartë për studentët dhe stafin akademik mbi zhvillimin e tyre dhe arritjet në rrugën e tyre akademike.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” është bazuar në zhvillimin e kompetencave që do të mundësojnë studentëve të zhvillojnë njohuritë e tyre në laboratorë dhe praktika profesionale. Rezultatet e studentëve, të përcaktuara në formën e kompetencave, pasqyrohen në programet lendore të cilat përfshijnë fazat e zhvillimit të njohurive të marra teorikisht. Njohuritë teorike zhvillohen përmes disa metoda: • Ushtrime/laboratorë në auditor: Realizimi i orëve të ushtrimeve dhe laboratorëve në auditor ka rolin kryesor në konkretizimin e njohurive të marra teorikisht. Ky është një ambient ku studentët mund të aplikojnë teorinë në praktikë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre. • Studim individual jashtë auditorit: Studentët janë inkurajuar të vazhdojnë studimin individual dhe zhvillimin e njohurive jashtë orarit të përcaktuar. Ky është një mënyrë për ta shtuar thellësinë e njohurive dhe aftësive të fituara gjatë orëve mësimore. • Projekte dhe detyra të kursit: Realizimi i projekteve apo detyrave të kursit përmirëson aftësitë e studentëve për të zgjidhur probleme të caktuara dhe për të krijuar një lidhje mes teorisë dhe praktikës. Personeli akademik në Departamentin e Shkencave të Mjedisit dhe Biologjisë Mjekësore Universitare mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve të caktuara.

	Diskutimet dhe puna në grup zhvillohen gjatë orëve të seminareve, seanca laboratorike, detyrave të kursit dhe studimit individual. Në këtë kontekst, studentët kanë qasje në burimet e bibliotekës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastrë [U-Library] dhe fondin e librit për të ndihmuar në zhvillimin e njohurive dhe për të gjetur materiale të nevojshme për punën e tyre. Universiteti dhe personeli akademik i DSHBMU-së inkurajojnë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete të programit të studimit, si dhe në programe mobiliteti, konferenca, projekte apo seminare studentore. Për këtë, ka një histori të dokumentuar të pjesëmarrjes në Panairin "Eorë and Study" dhe një listë të mobiliteteve të ofruara nga UGJ [Evidenca 11.15, 11.15.1, 1.25]. Kjo pjesëmarrje i ofron studentëve mundësi të shtuara për të zhvilluar idetë dhe mendimin e tyre, si dhe për të përfituar nga eksperiencia e programeve të ndryshme.
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik, i cili është i efektshëm dhe me kontratë, ka demonstruar përkushtim ndaj njohurive të reja dhe zhvillimeve në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Kjo angazhim është shprehur në realizimin e orëve të hapura dhe seminareve brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit. Disa nga aktivitetet dhe evidencat që dëshmojnë këtë përkushtim janë: - Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore i ugj dhe dshbmu: Këto plane tregojnë përfshirjen e personelit akademik në aktivitete të shumta kërkimore dhe shkencore. Plani për periudhën 2019-2023 përshkruan projektet, iniciativat dhe aktivitetet që janë zhvilluar nga personeli akademik në universitet [Evidenca 11.15, 11.15.1, 11.15.2, 11.15.3]. - Lista e personave dhe profesorëve të huaj të angazhuar në ugj: Një listë e personave të huaj të angazhuar në dhënien e titujve në UGJ tregon se universiteti ka këtij niveli të njohurive të tyre [Evidenca 11.15.4, 11.15.5]. - Projekti nderkombetar tecom: Pjesëmarrja në projektin TECOMP tregon për orientimin e personelit akademik drejt metodave të reja të mësimdhënies, përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në procesin e mësimdhënies [Projekti TECOMP, http://www.tecomp.ni.ac.rs/training-events]. - Qendra e të mesuarit gjatë gjithë jetës [Ill centre]: Ngritja dhe funksionimi i Qendrës së të Mesuarit Gjatë Gjithë Jetës tregon për një angazhim të vazhdueshëm për zhvillimin e aftësive dhe njohurive të studentëve përmes trajnimeve dhe aktiviteteve shtesë pas kryerjes së programit të studimit [Evidenca, Projekt-TeComp].

	Këto iniciativa dhe aktivitete dëshmojnë se personeli akademik është në përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të qëndruar në vijën e zhvillimeve të fundit shkencore dhe teknologjike.			
Konkluzione	- Programi i studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" ka një strukturë të kujdesshme dhe të organizuar me qëllim të siguruar thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. - Programi është i përgatitur që të sigurojë zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve, veçanërisht në fushat e biologjisë, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit, dhe kimisë së mjedisit. Gjatë vitit të parë të studimeve, gjuha e huaj përfshihet për të ndihmuar studentët në përdorimin e literaturës në gjuhë të huaja dhe për t'i përgatitur ata për burimet ndërkombëtare të informacionit. - Personeli akademik ka një përkushtim të vazhdueshëm ndaj përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimit të studentëve. Kjo përfshin fokusimin në çështjet kyçe gjatë procesit mesimor dhe sigurimin e orëve të konsultimeve për studentët. - Mësimdhënia bazohet në zhvillimin e kompetencave, duke përdorur metoda të ndryshme si ushtrime/laboratorë në auditor, studim individual jashtë auditorit, dhe projekte dhe detyra të kursit. - Pjesa e bibliotekës së universitetit dhe burimet e librit janë të hapura për studentët, duke u ofruar atyre mundësinë për të gjetur dhe përdorur materiale të nevojshme për studimet e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Institucioni ka hartuar rregullore të posaçme për provimin përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës në programin e studimit Bachelor në "Biologji – Kimi". Kjo është bërë në përputhje me dispozitat e Rregullores së Studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Rregulloren e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji - Kimi". Dispozitat specifike në lidhje me zhvillimin e provimit përfundimtar ose punimit të diplomës janë përcaktuar në Kreu VIII "Diplomimi" të Rregullores së Studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër [Evidenca 1.4], Nenin 93 të Rregullores së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër [Evidenca 1.2], Nenet 38 dhe 39 të Rregullores së FSHN-së [Evidenca 1.5], si dhe në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në "Biologji - Kimi"

	[Evidenca 1.9]. Në këto rregullore, përcaktohet pragu i notës mesatare mbi 8 që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. Kjo siguron një bazë të qartë dhe transparente për studentët në lidhje me kriteret e nevojshme për të kaluar në fazën përfundimtare të programit të studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik në DSHBMU asistojnë studentët në programin e studimit Bachelor në “Biologji – Kimi”, duke ofruar ndihmë dhe vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në periudhën e përgatitjes për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e punimit të diplomës. Kjo ndihmë është në përputhje me Rregulloren e Studimeve në Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastër, duke përfshirë shtojcat e kësaj rregulloreje, si dhe Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në “Biologji – Kimi” [Evidenca I.4, I.9]. Në fillim të vitit të fundit të studimeve, studentët kanë mundësinë të marrin informacione dhe udhëzime lidhur me provimin përfundimtar ose mbrojtjen e punimit të diplomës nga DSHBMU. Kjo përfshin edhe materialet e nevojshme për përgatitjen e tyre, siç është përcaktuar në Programin e provimit të përgjithshëm [Evidenca III.11]. Kjo mbështetje ka për qëllim sigurimin e transparencës dhe përgatitjes efektive të studentëve për fazën përfundimtare të studimeve të tyre në këtë program bachelor.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i përgjithshëm përfundimtar në programin Bachelor në “Biologji – Kimi” organizohet dhe administratohet nga një komision i posaçëm, i përbërë nga personel akademik i departamentit dhe miratuar nga dekani i fakultetit. Komisioni kryen hartimin e programit të provimit, duke përcaktuar tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Ky program miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe Dekani i Fakultetit, dhe pastaj përdoret si bazë për hartimin e tezës së provimit final. Teza e provimit përfundimtar hartohet nga anëtarët e komisionit, përfshirë pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit. Teza firmohet nga Përgjegjësi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit. Kjo siguron që pyetjet dhe materialet e përfshira në tezë janë në përputhje me fushat e studimit dhe njohuritë e marra gjatë viteve të studimit [Evidenca 1.4]. Ky proces transparent dhe i strukturuar ndihmon në vlerësimin e njohurive dhe aftësive të studentëve në mënyrë të përgjithshme, duke përcaktuar se në cilat fusha ata janë përgatitur më mirë
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas	Personeli akademik dhe udhëheqësi i diplomës në DSHBMU ndihmojnë studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Kjo bëhet në fillim të vitit të fundit të studimeve, ku fushat e studimeve për punimin e diplomës përcaktohen [Evidenca: III.11.1]. Udhëheqësi i temës së diplomës harton programin e punës së studentit, përcakton afatet dhe grafikun e konsultimeve. Në këto sesione, udhëheqësi kontrollon dhe konsulton punën e studentit sipas udhëzimeve të miratuara. Para mbrojtjes së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punën e kryer

udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	nga studenti, duke firmosur tëzen e diplomës. Procesi i punimit të diplomës zhvillohet duke iu përmbajtur udhëzimeve në Manualin e punimit të diplomës, të cilat janë pjesë e Rregullores së Studimeve në UGJ [Evidenca: 1.4, III 11.2]. Ky proces ka si qëllim garantimin e cilësisë së rezultateve dhe në fund, udhëheqësi miraton ose jo paraqitjen e punimit të diplomës para komisionit për mbrojtje. Kjo siguron një përpjekje të kujdesshme dhe të përgjegjshme nga ana e studentit dhe udhëheqësit të diplomës në përgatitjen dhe paraqitjen e punimit të diplomës.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	DSHBMU ofron infrastrukturë për lehtësuar studentët në kryerjen e matjeve, analizave, dhe testeve në mjediset laboratorike të institucionit. Për këtë qëllim, ata kanë mjete didaktike dhe teknologjike në dispozicion, siç tregohet në Inventarin e mjeteve didaktike dhe teknologjike në DSHBMU [vizita në institucion]. Ky burim i pasur i mjeteve dhe pajisjeve laboratorike është i rëndësishëm për studentët që studiojnë në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. Përveç kësaj, ndihma dhe mbështetja e udhëheqësve akademikë është e disponueshme për studentët gjatë përgatitjes së punimit të diplomës [Evidenca III 2.]. Kjo infrastrukturë siguron që studentët të kenë mundësi të kryejnë veprimtari praktike dhe hulumtuese në mjediset laboratorike, duke pasur përdorim të plotë të mjeteve të nevojshme për studimin e fushës së tyre të specializuar.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Ne përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomes, studenti vlerësohet me një notë. Ky vlerësim i bëhet sipas kriterëve dhe rezultateve të arritura gjatë provimit ose mbrojtjes së punimit të diplomes. Vlerësimi i fituar pasqyrohet në procesverbalin perkates, i cili është një dokument zyrtar që ruan informacionin mbi vlerësimin e studentit. Procesverbalin e harton komisioni i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose i mbrojtjes së punimit të diplomes. Ky dokument përfshin të dhënat relevante për studentin, vlerësimin e tij, dhe komentet e komisionit në lidhje me performancën e tij. Pas hartimit të procesverbali, të gjithë anëtarët e komisionit dhe studenti vetë nënshkruajnë dokumentin për të vërtetuar dhe legalizuar rezultatin e arritur. Ky proces dhe dokumentacioni i duhur [Evidenca I.4, III.11.2] përbën një mjet të rëndësishëm për transparencë dhe dokumentim të vlerësimit të studentëve në fazën përfundimtare të studimeve të tyre.
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve,	Ne përfundim të studimeve, studentet e programit të studimit Bachelor në "Biologji – Kimi" janë të pajisur me diplomën dhe suplementin e diplomës. Ky proces ndjek rregulloren dhe procedurat e vendosura nga institucioni arsimor dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. [Evidenca 1.4: 1.2, 11.5: 11.6.1]. Suplementi i Diplomës, sipas Evidencave II.6.2, është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 "Për

studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës" të MASR. Ky dokument përmban informacion të vecante rreth natyres, nivelit, përmbajtjes, dhe rezultateve të studimeve që janë kryer dhe perfunduar me sukses nga studenti. Pasi studenti diplomohet, ai ka te drejtë të kërkojë dhe të marr një kopje të plote zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, duke përfshirë syllabuset perkatese të lëndëve. Kjo bën që studenti të ketë një dokument të plote dhe të verifikueshem të rruges se tij studimore.
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë [UGJ], ka një sistem të rregullt për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studenteve, duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe parimet e konfidencialitetit [Evidenca I.1, III.13], Sipas këtyre dokumenteve, UGJ administron dokumentacionin e studenteve duke ruajtur regjistrin themeltar të studenteve. Ky proces zhvillohet me respekt ndaj ligjit të arsimit të lartë, statutit të universitetit, dhe rregullores së sekretarise mesimore. Studentet kanë te drejte të terheqin dokumentacionin e tyre personal në mbyllje të studimeve. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe perpunimit të të dhënave personale të studenteve janë të mbrojtura nga parimet e konfidencialitetit dhe janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
Konkluzione	• Programi i studimit Bachelor në "Biologji - Kimi" është i organizuar me kujdes për thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. • Veprimtaritë formuese përfshijnë mësim në auditor dhe studim individual. Pjesa e detyrimeve përfshin përfundimin e aftësive në lëndë të ndryshme dhe përgatitjen e tezës së diplomës. • Rregulloret për provimin përfundimtar dhe punimin e diplomës janë hartuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e institucionit. • Komisioni i provimit përfundimtar harton programin dhe tezën, duke siguruar që pyetjet dhe materialet janë në përputhje me fushat e studimit. Udhëzimet dhe mbështetja për punimin e diplomës asistojnë në përgatitjen efektive të studentëve. • Mjetet laboratorike janë në dispozicion për të lehtësuar veprimtaritë praktike dhe hulumtuese. Përveç kësaj, programi ka një sistem të strukturuar për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të studentëve. • Pasi studenti diplomohet, ai mund të kërkojë një kopje të programit të studimit dhe të dokumentave të tjera të rrugës së tij studimore. Institucioni ruajt dhe administron dokumentacionin duke respektuar ligjin dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të studentëve.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion, rezultojnë se institucioni ka përvorë dhe kapacitet akademike për të përmbushur të gjitha objektivat e programit të studimit. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Natyrore i cili përbëhet nga 3 departamente: • Departamenti i Matematikës, fizikës dhe informatikës; • Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit; • Departamenti i Infermierisë. Departamenti i Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në "Biologji Kimi". Personeli akademik dhe ndihmës akademik, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, kanë formimin e duhur profesional dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. Staf akademik i përfshirë në këtë program studimi përbëhet nga personel në fushën e Biologjisë dhe Kimisë. [Ev. III.4.; Ev. ANEX, Tab Permbledhese: Tab 12.1, 12.2, 12.3 plani mesimor]. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbas vizitës në institucion, [Tabelat permbledhese Ev ANEX, cilesia e stafit mesimdhënes 6.1, 6.2, 6.3], stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon: 1. Për vitin akademik 2020- 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 13 pedagogë nga të cilët 8 PAE [1 Prof. Dr., 4 Prof. As., 2 Dr, 1 Msc] dhe 5 PAK [1 Prof. Dr., 4 Msc]; 2. Për vitin akademik 2021- 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 12 pedagogë nga të cilët 8 PAE [1 Prof. Dr., 4 Prof. As., 2 Dr, 1 Msc] dhe 4 PAK [1 Prof. Dr., 3 Msc]; 3. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 14 pedagogë nga të cilët 8 PAE [1 Prof. Dr., 4 Prof. As., 3 Dr] dhe 6 PAK [1 Prof. Dr., 5 Msc]. Koordinatori i programit të studimit zotëron aftësitë profesionale dhe eksperiencën praktike të nevojshme, për të përmbushur funksionet e tij.
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për	Për realizimin e programit Bachelor në "Biologji kimi", janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj dhe grada shkencore apo Msc. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion të GVJ, është paraqitur lista e stafit akademik të përfshirë në realizimin e

programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	programit mësimor në këtë program studimi [Ev. III.4. Ev. ANEX, Tab Permbledhese; Tabelat permbledhese Ev ANEX, cilesia e stafit mesimdhene 6.1, 6.2, 6.3]. Nga shqyrtimi i dokumentacion mbi Planit mësimor dhe CV të stafit akademik, GVJ konstaton se formimi profesional i pedagogëve përputhet lënda që ata zhvillojnë në programe studimit. Referuar [Ev. ANEX, Tab Permbledhese: Tab 12.1, 12.2, 12.3 plani mesimor] Nga sa më sipër rezulton që për të tre vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi bachelor, është përballuar me jo me pak se 75% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Departamentit ku zhvillohet programi i studimit, si dhe CV e stafit akademik konstaton se në tre vite të fundit stafi akademik është stabil. GVJ evidenton se gjatë këtyre viteve, nga shqyrtimi me sondazh i kontratave të punës konstatohet, se janë paguar rregullisht sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe dosjet janë të plotësuara me të gjithë dokumentat e nevojshëm. [Ev. IV.3 Listapagesat; Ev.IV.3.3 Model kontrate punesimi].
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Gjatë vizitës në Zyrën e Burimeve Njerëzore të institucionit, GVJ u njoh me procedurat e rekrutimit të stafit, me modelet e kontratave të punës. GVJ verifikoi me sondazh dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe të stafit të ri akademik me kontratë. Institucioni disponon rregullore të veçantë në lidhje me kriteret e kandidatëve edhe procedurën e rekrutimit të miratuar nga Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Cabej” [Ev. 1.1 Statuti IAL; Ev. 1.2 Rregullore IAL: nenet 27,29; Ev. 1.27.1 Rregullore e punesimit]. Procedura e rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë apo të pjesëshme realizohet nga njësi bazë duke propozuar komisione Ad-hock sipas bazës ligjore dhe nën ligjore, si dhe akteve të brendshme rregullatore të UGJ. Procedurat e rekrutimit të personelit janë transparente, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në statutin dhe rregulloren e institucionit. Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik, procedura u verifikua nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion dhe nga takimet e realizuara me titullarët. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me sistem pikëzimi. Nga shqyrtimi me sondazh i dosjeve të personelit, GVJ konstatoi se është i pranishëm dokumentacioni i kërkuar. Rekrutimi i stafit kryhet sipas akteve rregullatore të miratuar nga IAL dhe në kodin e punës. Në diskutimin me pedagogët, u konstatua se ata njihen paraprakisht me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga lidhja e kontratës së punës. Bazuar në statusin e UGJ dhe kodin e punës Institucioni ka hartuar procedura e kritere për rekrutimin e personelit. [Ev. IV.6a; Ev. IV.6b].

Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, evidentohet angazhimi i personelit ndihmës akademik, të cilët asistojnë në orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirëmbajtjen e laboratoreve mësimore. Personeli ndihmës akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij. [Ev.IV.7 Detyrat dhe ngarkesa e personelit ndihmes akademik; Ev. III.4.1 CV e personelit ndihmes akademik].
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ, konstatoi se UGJ, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Biologji kimi”. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, ku disponohen dosjet personale të stafit akademik e cila, mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për çdo semestër, si dhe dosjen personale për staf jo akademik [Ev. IV.5; Ev. IV.3.2]. Çdo vit Zyra e burimeve Njerëzore bën dhe përditësimet në bazën elektronike të të dhënave dhe dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni ka vënë në dispozicion listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë, ngarkesën e tyre mësimore si dhe kualifikimet e tyre. Gjithashtu GVJ evidentoi që çdo fund viti akademik, pedagogët hartojnë, dorëzojnë dhe miratojnë pranë drejtuesit të departamentit evidencat e realizimit të ngarkesës mësimore për vitin akademik të mbyllur, proces pune ky, i koordinuar nga Drejtuesi i Departamentit, Drejtoria e Kurrikulave dhe Standardeve të Cilësisë. Të dhënat përfshijnë listat e personelit të angazhuar për çdo semestër dhe vit akademik, në përputhje edhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. [Ev.VI.2; Ev VI.6.1 Raport vleresimi cilesie 2020-2021; Ev VI.6.2 Raport vleresimi cilesie 2021-2022; Ev. IV.2].
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit Bachelor në “Biologji kimi” institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit si, Drejtoria Rajonale e Arsimit, Drejtoria Rajonale e Spitaleve. Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundur: – Realizimin e praktikave – Realizimin e temave të diplomave [Ev. 1.23. Lista e marreveshjeve te bashkepunimit te UGJ; Ev. IV 9.2] Praktikat mësimore, laboratorike zhvillohen duke shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të vetë institucionit [Takimi me Dekanin dhe Përgjegjësën e Departamentit, Vizita në Institucion]. Marrëveshjet kanë si qëllim kryerjen dhe mbështetjen e praktikës profesionale si dhe realizimin e diplomës. Marrëveshjet janë të lidhura

	në nivel Institucional dhe zbatohen nga njësia bazë. <i>Ky program studimi nuk e ka përfshirjen e praktikës të detyruar profesionale. [Ev II.9.1 Plani mesimor]</i> GVJ i sugjeron institucionit të zgjerojë bashkëpunimin dhe me institucione të tjera private apo publike, si mundësi për të mbështetur dhe zgjeruar kapacitetet për realizimin e praktikave mësimore dhe për realizimin e temave të diplomës.			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	<i>Programi i studimit bachelor “Biologji kimi” nuk e ka përfshirjen e praktikës të detyruar profesionale. [Ev II.9.1 Plani mesimor 2021-2022]</i>			
Konkluzione	<i>-Për realizimin e programit të studimit Bachelor “Biologji kimi”, IAL ka angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë, që zotërojnë tituj dhe gradë shkencore apo Msc.</i> -rreth 75% e ngarkesës mësimore realizohet nga stafi akademik efektiv. <i>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Planit mësimor dhe Cv të stafit akademik, GVJ kostaton se formimi profesional i pedagogëve përputhet me lëndë që ata zhvillojnë në programin e studimit.</i> <i>-IAL, disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit Bachelor në “Biologji kimi”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me mjediset e fakultetit dhe departamentit. Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentët janë të përshtatshme dhe në plotësim të standarteve për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor. UGJ, zhvillon procesin mësimor në një godinë me kushte optimale për zhvillimin e këtij procesi, si dhe me kushtet e nevojshme për zhvillimin e laboratoreve dhe lëndëve të formimit të përgjithshëm. Në

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.asc.al

Faqe 47

specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	dokumentacionin e dorëzuar përshkruhet infrastruktura e nevojshme, sipërfaqet, sallat e leksioneve dhe seminare, laboratorët mësimore, laboratorë të informatikës, ambientet ndihmëse çlodhëse në funksion të stafit dhe studentëve, zyra për stafin të mirëpaisura, bibliotekë si dhe hapësira të jashtme. Auditorët kanë hapësira të mjaftueshme, të ndriçuara. Njësia bazë ka në dispozicione mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Organizimi i orarit mësimor është bërë në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. [Ev. IV.10.1; Ev IV.10.2; Ev.II.13.; Ev. IV.10 Infrastruktura e UGJ; Ev ANEX Tab 16 Mjediset e FSHN/DBK]
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Ambientet e mësimdhënies janë të mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit. Sallat e leksioneve dhe seminareve, apo te laboratoreve kanë numrin e mjaftueshëm të vendeve për studentët të cilët janë të organizuar në grupe, në raport me numrin e vendeve në sallë. Ambientet e UGJ kanë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit, të cilat u konstatuan dhe gjatë vizitës në institucion. GVJ vizitoi auditorët mësimorë, laboratorët dhe sallat e leksioneve dhe konstatoi se pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënien në përputhje me qëllimet e programit. Në funksionin e programit janë në dispozicion mjete elektronike audio vizive dhe të teknologjisë së informacionit, si kompjutera, videoprojektorë, kryesisht në sallat e leksioneve. Ndriçimi natyral dhe ai artificial ishte i bollshëm dhe i dedikuar për ambientet mësimore. Në dispozicion të personelit akademik dhe administrativ, ekzistojnë ambiente të mjaftueshme për punë dhe studim. Në ambientet e fakultetit ku zhvillohet programi i studimit Bachelor në “Biologji Kimi”, gjenden laboratorët e lëndëve të formimit bazë. [Vizita e ambienteve; Ev. III.2]
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se UGJ zotëron 9 [nente] laboratorë mësimorë në funksion të programeve të studimit që zhvillohen në Departamentin e Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit, apo departamente të tjera të FSHN. Laboratorët në funksion të këtij programi studimi përfshijnë laboratorët e zoologjisë, të botanikës, të fiziologjisë shtazore, të kimisë organike, të anatomisë së njeriut, kimisë inorganike, analitike dhe fizike. Mjediset janë të ndriçuara dhe janë gjithmonë funksionale dhe në dispozicion të studentëve. Në dispozicion të tyre është dhe biblioteka, e cila është e pajisur me materiale mësimore dhe libra. [Ev. III.2 Inventari i mjeteve didaktike; Ev. III.3 Inventari i mjeteve laboratorike; Vizita e ambienteve në IAL]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Në funksion të realizimit të programit të studimit Bachelor në “Biologji Kimi”, janë dhe 4 [kater] laboratore Informatike. Laboratori është i pajisur me kompjutera dhe programe që përdoren nga studentët pa pagesë. [Ev. IV.10 Infrastruktura UGJ; klasa digjitale]

Konkluzione	<i>-Infrastruktura, mjediset mësimore, teknologjia e informacionit, shërbimet për studentë tjanë të përshtatshme për zhvillimin e një procesi cilësor mësimor.</i> <i>-UGJ/FSHN zotëron laboratorë mësimor në funksion të programit të studimit, që zhvillohen në Departamentin e biologji kimisë, apo departamante të tjera të FSHN.</i> <i>-Në funksion të programit të studimit Bachelor në "Biologji kimi", janë labororet e Informatikës, të pajisur me kompjutera dhe programe që përdoren nga studentët pa pagesë, për qëllim mësimi apo përgatitje të detyrave të kursit dhe/ose mikrotezës</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, [bibliotekën, mjedise të posaçme].	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit [fizike dhe digjitale] garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe, si dhe leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit. GVJ nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për këtë program studimi, si dhe nga vizita në Institucion konstatoi se në bibliotekë ka libra fizike të autoreve shqiptar si dhe të huaj. Materialet janë si për të mbuluar pjesën e lëndëve bazë, ashtu edhe për ato të lëndëve profesionale. [Ev. IV.12.1 Miratimi i literatures baze në FSHN; Ev. 11.30 Syllabust 2020-2023].
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimeve me stafin drejtues, u deklarua që çdo fillim viti akademik, titullari i lëndës/ pedagogu dorëzon në njësinë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Biologji Kimi", programet lëndore ku jepen detaje mbi literaturën e detyruar bazë dhe të rekomanduar e cila duhet të jetë e përditësuar me botime bashkëkohore. Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ evidentoi një numër titujsh, që u evidentuan dhe gjatë shqyrtimit të syllabuseve, GVJ evidentoi që literatura e detyruar dhe e rekomanduar në syllabuse është e vjetëruar dhe në një pjesë të konsiderueshme të lëndëve bazohet në libra të viteve më parë dhe me leksione të shkruara nga vetë pedagogët. Në takimin me stafin akademik u theksua se çdo vit akademik paraqiten kërkesa për tekste dhe literaturë bashkëkohore dhe parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore. <i>GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me libra të viteve të fundit, si dhe shtimin e literaturës fizike profesionale.</i> [Ev. 11.30 Syllabust 2020-; Ev. IV.13; Ev IV.13.1 Ev. III.9]

Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	FSHN ofron për studentët një bibliotekë me hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët. Mjediset e bibliotekës kanë kapacitete në tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj. Ambientet e bibliotekës janë të hapura në çdo kohë dhe kanë mundësi shfrytëzimi në mënyrë të barabartë nga studentët. UGJ ka vënë në dispozicion dhe përdorimin e librave elektronikë. [Ev. III.9; Ev. IV.14]
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës GVJ evidentoi që Biblioteka e UGJ, është e pajisur me tekste universitare, libra e revista në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo ka një fond fizik të literaturës mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të huaja, tituj librash elektronikë. Këto materiale mbulojnë pjesën më të madhe të moduleve dhe veprimtarive mësimore, të këtij programi studimi. <i>Megjithatë GVJ rekomandon që literatura duhet të pasurohet më tej me botime të fundit dhe me tituj të rinj në fushën e shkencave biologji kimi, si dhe të shtohen botimet e fundit profesionale.</i> [Vizita e ambienteve në institucion].
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. UGJ ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë, si të bibliotekës fizike ashtu dhe asaj on-line. Kapacitet e bibliotekës ofrojnë kënde pune për punë në grup, kompjutera me mundësi akses në internet. Të gjitha këto kapacitete mund të shfrytëzohen nga studentët e programit të studimit “Biologji kimi”, për të studiuar, realizuar detyrat dhe projektet e kursit apo prezantuar projektet e tyre. Nga ana tjetër të gjitha punimet, materialet didaktike, librat universitar duhet të depozitohen në bibliotekë, duke e pasuruar më shumë atë. [Ev. IV.14.1; https://ulibrary.rash.al; Vizita e ambienteve në institucion]
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka siguron literaturë fizike dhe digjitale/on line në ndihmë të studentëve dhe stafit akademik. Ashtu sic u shprehëm edhe më sipër, institucioni ka krijuar kushtet që ambjentet e bibliotekës të jenë të pajisura me kompjutera ku mund të përdoren nga të gjithë studentët e interesuar. [Ev. III.9 Informacion mbi bibliotekën U-library; Vizita e ambienteve në institucion]
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët. Gjatë vizitës në institucion, nga GVJ u identifikua se oraret e shërbimit të bibliotekës ishin të afishuara 08.00 – 19.00 për çdo ditë të javës, orare këto në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevoja të studentëve. Institucioni ka punonjës të veçantë për bibliotekën, të cilët përgjigjen për mirëmbajtjen e saj dhe përmbushjen e nevojave të studentëve.

	[Ev. IV.14.2 Rregullore e bibliotekes; Vizita e ambienteve në institucion]			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online [titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit], përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	UGJ planifikon çdo vit buxhet të veçantë për pasurimin e fondit të bibliotekës me tituj të rinj apo përditësim të fondit ekzistues në funksion të programeve mësimore. Propozimet për titujt apo tekste, vijnë nga departamentet e fakulteteve dhe përgatiten nga stafi i bibliotekës i cili përgatit listën e teksteve të kërkuara me buxhetin përkatës dhe i dorëzon në rektorat. Në takimet me stafin akademik dhe në RVB theksohet se në çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore, të cilat më pas parashikohen në buxhetin e Fakultetit. [Ev IV.13.1 Raportime nga biblioteka per departamentin; Vizita e ambienteve në institucion].			
Konkluzione	- UGJ / FSHN ofron për studentët një bibliotekë me hapësira të dedikuara për studentët. -Oraret e shërbimit të bibliotekës ofrohen sipas një kalendari të miratuar dhe të afishuar në ambiente te bibliotekës. -Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhë nshqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/ të printuara për programet e studimit. -Biblioteka në UGJ siguron literaturë fizike dhe digitale/ on line ku, studentë tmund të konsultohen me materiale në gjuhë të huaj. -Pavarësisht numrit të lartë të titujve, literatura e biologji kimise ishte e varfër në tituj të viteve të fundit. GVJ rekomandon pasurimin e kësaj literature me tekste dhe botime të viteve të fundit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë	UGJ disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim, në programin e studimit. Sekretaria

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 51

informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	mësimore dokumentacionin e ruan në dy forma: shkresore dhe elektronike [Sistemi Pitagora nga RASH]. Ajo është përgjegjëse për regjistrat, hedhjen e të dhënave dhe për marrëdhëniet me studentët. Ky sistem menaxhimi siguron ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Kolegjit. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku, në mënyrë konfidencial e mer informacionin për rezultatet e provimeve, regjistrohet në lëndët që do të frekuentojë apo provimet që do të japë gjatë vitit akademik. Sekretaria mësimore kanë formë shkresore: 1. Rregjistrin themeltar të studentëve; 2. Rregjistrin me të dhënat akademike; 3. Rregjistrin e lëshimit të diplomave; Rregjistrat ruhen pa afat dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Sekretaria mësimore arkivon: - Dosjet e rregjistrimit të studentëve me gjithë dokumentacionin përkatës; - Proçesverbalet me rezultatet e provimeve të studentëve; - Dosjet e diplomimit – Dokumentacioni që verifikon plotësimin e kushteve për diploma, proçesverbalet e notave të provimit/temave të diplomës, listën e të diplomuarve përcjellë rektoratit për miratim, fotokopje të diplomave të tërhequra; Në sistem kanë akses pedagogët, studentët, sekretaria mësimore. Të gjitha opsionet e mundëshme janë të përcaktuara në rregulloren e përdorimit të sistemit Pitagora, nga secili prej përfitueve të tij, rregullore e hartuar nga Zyra e IT. [Ev. Iv.15]
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka dokumentacion të plotë lidhur me stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në realizimin e programit mësimor. Menaxhimi i këtyre të dhënave realizohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore: Rregjistri themeltar, dosjet personale të stafit akademik PAE dhe PAK, ndihmës akademik dhe administrativ, CV, librezë e punës, kontratat e punës proçedurat e punësimit, etj, ruhen në arkivën e IAL. [Ev. IV.5, Neni 3, 4, 5; Ev. IV.8.1]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në	Gjatë vizitës në institucion u verifikua se Institucioni ka sistem të brendshëm të menaxhimit të të dhënave dhe informacionit, i cili



informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	funksionon në bazë të rregullores përkatëse. Staf i akademik dhe studentët kanë akses për informacione apo dokumenta të nevojshëm në dobi të programit të studimit. Në sistemin Pitagora, në regjistrat e sekretarisë dhe në zyrat e sekretarisë së titullarit të njësive kryesore [fakultetit] pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet, si dhe të dhëna të rezultateve gjatë viteve të studimit, të dhëna për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, programe të studimit kurrikular, të dhëna financiare në lidhje me tarifat e studentëve dhe pagesa të kryera. Institucioni disponon sistemin e tij elektronik të të dhënave Pitagora. Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentët, stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Çdo student ka portofolin e tij elektronik, me akses personal, me të dhëna konfidenciale. Misioni i programit, Plani mesimor, struktura mesimore, Oraret e mesimit publikohen në faqen zyrtare të UGJ-se https://uogj.edu.al
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Paltformat elektronike si: Microsoft 365, Microsoft Teams. etj., përfshijnë edhe komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve. Një vend të rëndësishëm zë edhe shpërndarja e informacionit që lidhet me mbarrëvajtjen e procesit mësimor. UGJ është pilotuar për platformën elektronike “learningKey” nga Projekti Erasmus + TeComp, me funksionalitet: Krijimin e kurrikulave, etj. Duhet përdorur dhe për detyrat e shtëpisë, platformën e testimit, klasa virtuale, etj. [Ev. III.1.4; Ev. III.1.5 Manuali përdorimit TEAMS për studentët; Ev. IV.18]
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Në sistemin e menaxhimit platformat elektronike [ESSER3, Pitagora, TEAMS, etc.] si dhe sekretaria mësimore kanë krijuar mundësinë e monitorimit në kohë reale të të gjitha të dhënave dhe mundësinë e gjenerimit të raporteve në lidhje me frekuentimin, rezultatet, etj. Kjo llogari mundëson pasqyrimin e aktivitetit akademik semestral dhe komunikimin midis stafit për problematikat që lindin nga pasqyrimi i vlerësimit në sistem. [Ev. 14; Vizita në institucion]
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Faqja zyrtare përmban informacion kryesor në lidhje me IAL: misionin, drejtimin, funksionimin dhe organogramën. Faqja zyrtare jep informacion mbi fakultetet, kërkimin shkencor, shërbime të tjera që ofrohen nga UGJ, programet mësimore që ofron çdo fakultet sipas departamenteve. Faqja zyrtare përmban informacion të plotë mbi aktivitetet e organizuara nga UGJ, stafin akademik, programet dhe sylabuset e lëndëve, fakultetet, departamentet dhe programet mësimore që zhvillohen nëse cilin departament, orarin mësimor etj, <i>por, platforma e web duhet të shërbejë si një platformë, ku studenti</i>



	mund të marrë informacionet e pedagogeve për materiale të ndryshme në lidhje me lëndë specifike. Informacioni paraqitet në 2 gjuhë, në gjuhën shqipe dhe atë angleze. https://uogj.edu.al/			
Konkluzione	-UGJ disponon sistem menaxhimi nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit, sistemin Pitagora. -Sistemi i menaxhimit të informacionit ka të integruar sistemin e brëndëshëm Pitagora, ku hidhen, ruhen dhe përpunohen të dhëna në lidhje me vlerësimin e studentit. -Faqja zyrtare UGJ përmban informacionet kryesore në lidhje me: misionin, drejtimin, funksionimin, organogramën, etj. - Platformën elektronike "learningKey" nga Projekti Erasmus + TeComp, mendojmë se duhet përdorur dhe për detyrat e shtëpisë, platformën e testimit, klasa virtuale, etj. -Portali i UGJ-së duhet të shërbente si një platformë, ku studenti mund të marrë informacion në websit-et e pedagogeve për materiale të ndryshme në lidhje me lëndë specifike. -Faqja zyrtare është bërë në dy gjuhë: në gjuhën shqipe dhe angleze <u>Rekomandim:</u> Portali i UGJ-së duhet të shërbejë si një platformë, ku studenti mund të marrë informacion në websit-et e pedagogeve për materiale të ndryshme në lidhje me lëndë specifike.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit akademik UGJ, harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit, për të paktën një cikël të plotë studimi. Hartimin e këtij plani, bazuar në statutin e IAL-së, e realizon Drejtoria e Menaxhimit në Drejtorinë e shërbimeve universitare të IAL dhe buxheti miratohet nga Bordi i Administrimit. Bordi i Administrimit miraton gjithashtu edhe një fond të veçantë për mbështetjen e aktiviteteve të studentëve, apo kërkimet shkencore të stafit. [Ev. 1.1 Statuti UGJ; Ev. IV.16.4 Projekt buxheti per 2023]

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Çdo vit akademik FSHN në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin. Pjesë e buxhetit janë pagat e stafit akademik dhe mbështetës, tarifat e shkollimit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor apo shpenzime të tjera në funksion të realizimit të programit; investimet, kontratat e shërbimeve në funksion të programeve të studimit dhe aktiviteteve trajnuese. Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacion për të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarje të burimeve financiare për çdo vit akademik. Në fund të çdo viti, institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programe vetëstudimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimi që bën çdo fakultet. [Ev. IV.16.1; Ev. IV.16.2 Raport vjetor financiar per 2021; Ev. IV.16.3 Raport vjetor financiar per 2022; Ev ANEX, Tab 18 permbledhese]
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Institucioni deklaron se kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Ky dokumentacion hartohet dhe administrohet nga Zyra e Financës së IAL. <i>GVJ nuk gjeti ndonjë raport auditimi.</i> [Ev. IV.16.1 Raport vjetor financiar per 2020; Ev. IV.16.2 Raport vjetor financiar per 2021; Ev. IV.16.3].
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në përfundim të vitit, Njësia bazë dhe ajo Kryesore njihet me raportin financiar të institucionit nga Drejtoria e Shërbimeve Universitare të UGJ. Ato marrin informacion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës. Raporti financiar pasqyron në mënyrë tabelore informacionin për të ardhurat financiare nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarje të burimeve financiare për çdo vit akademik. Në fund të çdo viti institucioni harton raportet financiare për realizimin e buxhetit si dhe përgatit buxhetin afat mesëm për funksionimin e institucionit dhe programeve të studimit. Hartimi i buxhetit mbështetet në kërkesat dhe planifikimin që bën çdo fakultet. [Ev. IV.16.1; Ev. IV.16.2; Ev. IV.16.3]
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni	UGJ, garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij bazuar në: - Financimet nga buxheti i shtetit; - Të ardhurat dytesore që siguron nga tarifat e shkollimit, dhe jo vetëm. [Ev. Ev ANEX, Tab 18 permbledhese: Te ardhurat dhe financimet e ndryshme ne 3 vitet e fundit]]

planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	<i>UGJ krahas sigurimit jo teresisht te bazës materiale per procesin mesimor duhet të investojë për kerkimin shkencor.</i>			
Konkluzione	<i>-Çdo vit akademik UGJ harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</i> <i>-Shpërndarja e fondeve bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara per mesim në cdo fillim viti akademik.</i> <i>-Çdo vit akademik FSHM në bazë kërkesave dhe planifikimeve të Departamentit, harton buxhetin i cili miratohet nga bordi i adminstrimit.</i> <i>- Në përfundim të vitit, Njësia bazë dhe ajo Kryesore njihet me raportin financiar të institucionit. Ato marrin informacion mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës dhe planifikimin e buxhetit për vitin pasardhës.</i> <i>-Universiteti garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij, bazuar në të ardhurat që siguron.</i> <i>Rekomandohet qe te kete nje ndarje me te mire per buxhetin ne baze te njesise baze dhe te kete dhe buxhet per mbeshtetjen e kerkimit shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti “Eqrem Cabej” Gjirokastrë dhe Fakulteti Shkencave Natyrore, kanë hartuar Statutin dhe Rregulloren në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje. Këto procedura janë në përputhje të plotë me Satutin e IAL, rregulloret e FSHN, rregulloren e Departamentit të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit dhe akteve të tjera ligjore dhe nën ligjore. Në këtë dokumentacion përcaktohen procedurat e propozimit të kuotave të pranimit, procedura te transferimit të studimeve dhe ndjekjes së programeve të dyta. Procedura e pranimit realizohet mbibazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit bachelor në “Biologji kimi”, si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve [MAS]. Në rregulloren e departamentit dhe programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë për strukturën e fakultetit, programet e studimeve që ofrohen, organizimin e programeve, diplomimin etj. Në funksion të informimit dhe ndjekjes së studentit nga regjistrimi në diplomim, funksionon dhe sekretaria mësimore. Informacioni udhërrëfyes për studentët gjendet dhe në faqen eeb të universitetit. Kohezgjatja normale e studimeve në këtë program studimi është tri vite akademike dhe studenti diplomohet me provim te pergjithshëm perfundimtar ose punim diplome. [Ev. 1.1 Statuti IAL; Ev 1.2 Rregullore e UGJ; Ev 1.5 Rregullore e FSHN; Ev 1.7 Rregullore e DBK; Ev 1.9 Rregullore e programit te studimit Bch]
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	FSHN ofron mundësi të barabarta për të gjithë studentët e programit të studimit. Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente duke respektuar meritokracinë. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e studentëve janë përcaktuar në aktet rregullatore të brendshme të institucionit. [Ev 1.2 Rregullore e UGJ; Ev 1.5 Rregullore e FSHN; Ev 1.7 Rregullore e DBK; Ev 1.9 Rregullore e programit te studimit Bch]
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u	Para çdo viti akademik pas kërkesës së MAS, departamenti përcakton kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të cilat të cilat miratohen nëdekanat dhe aprovohen nga Senati akademik. Kuotat përcaktohen në bazë të kapaciteteve njerezore, akademike dhe ato logjistike. Senati

pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	akademik i dërgon kuotat dhe kriteret e pranimit në MAS. Kriteret dhe kuotat e pranimit publikohen në portalin e universitetit: https://uogj.edu.al/studentet/kriteret-e-pranimit. Në këto kriteret përfshihen dhe parashikohen edhe regjistrimi i studentëve të huaj. Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve janë të përcaktuar në rregulloren e UGJ dhe Fakultetit të Shkencave Natyrore. Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA përprocedurat e regjistrimit dhe të transferimit të studentëve. [Ev. V.3; Ev 11.20 Procedure e transferimit te studenteve]
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në rregulloren e departamentit, në statutin e IAL dhe në ëeb janë paraqitur qartë e në mënyrë të kuptueshme informacionet për: • Organizimi ne programeve të studimit; • Kriteret për pranimet në ciklin e parë dhe të dytë; • Proçedura te miratimit të kuotave dhe tarifave; • Ndërprerjen e studimeve, proçedurat e transferimit apo të ndjekjes së një programitë dytë studimi; • Rregullat e ekuivalentimit etj. Rregullorja e departamentit, Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset kanë informacion të qartë e të detajuar për format e mësimdhënies, planin mësimor, mënyrën e kontrollit të dijeve, realizimin e praktikës dhe detyrave të kursit, proçesin e diplomimit me provim/temë diplome. Informacioni për studentët është transparent dhe gjendet i publikuar dhe në faqen ëeb të UGJ. Kriter i përgjithshëm i pranimit është nota mesatare e shkollës së mesme e përcaktuar me VKM. Diploma e arsimit të mesëm e marrë në një shtet të huaj duhet të njihet më parë nga struktura përkatëse në MAS. Në takimin me studentët GVJkonstatoi se studentët janë të kënaqur me aksesin në informacion, me funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës, me funksionimin e sekretarisë mësimore në ndihmë të tyre. Në statusin e IAL dhe Rregulloren e DBK përcaktohen proçedurat e përcaktimit të kuotave dhe tarifave për programin e studimit. Institucioni ka parashikuar dhe kuota për regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara. Të gjithë informacionet e mësipërme gjenden të publikuara në: • Website e UGJ https://uogj.edu.al/studentet/ [Vizita në institucion;Ev 1.2 Rregullore e UGJ; Ev 1.5 Rregullore e FSHN; Ev 1.7 Rregullore e DBK; Ev 1.9]
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e	UGJ ka në traditën e tij organizimin e ditëve të hapura informuese për publikun - Panair, në të cilat, prindër dhe gjimnazistë nga gjimnaze te qarkut të Gjirokastrës dhe të qarqeve fqinjë, të cilët janë të interesuar për programet e studimit që ofrohen nga kjo IAL, informohen nga

kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	pedagogë dhe studentë. Këto aktivitete organizohen zakonisht sipas një kalendari i cili rakordohet me Drejtoritë Rajonale të Arsimit, dhe kanë në fokus njohjen e të interesuarve me kriterete përgjithshme dhe specifike për t'u pranuar në programet e studimit, mundësitë e shkollimit dhe punësimit pas mbarimit të programeve të studimit etj. Informacioni gjendet gjithashtu në faqen ëeb të UGJ: https://uogj.edu.al/studentet/kriteret-e-pranimit. [Ev. 11.15 Pjesëmarrje ne Panairin Work and Study; Ev V.4 Kalendari i zhvillimit te dites informimit maturanteve; Ev. V.4.2]
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Para fillimit të çdo viti akademik UGJ, parashikon kuota të caktuara dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Këto kriteret dhe kuota bëhen publike përpara fillimit të çdo viti akademik dhe publikohen edhe në website-in e fakultetit. [Ev. V.2 Kuotat e pranimit; Ev V.1 Kriteret e pranimit]
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Pas diskutimit me drejtuesit e njësive kryesore dhe të njësive bazë, UGJ harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga Republika e Kosovës dhe trojet shqipfolëse, të cilët janë të interesuar për të ndjekur studimet. Këto kriteret janë përputhje me aktet nënligjore të MAS. Kuotat e pranimit llogariten mbi bazën e studentëve aktivë, që ndjekin programet e studimit. Ato bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë përgjegjëse për arsimin. [Ev. V.2 Kuotat e pranimit; Ev V.1 Kriteret e pranimit]
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Universiteti "Eqrem Cabej" Gjirokastrë, çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë në varësi të arritjeve akademike. [Ev. II.14 Vendime Bordin Administrimit për bursa; Ev.II.14.4; Ev.II.14.5]
Konkluzione	<i>IAL ka hartuar Statut edhe Rregullore në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto dokumenta janë shkruar qartë politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje.</i> <i>-Procedurat e pranimit realizohen mbi bazën e kriterëve specifike të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit Bachelor "Biologji kimi", si edhe sipas Udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve.</i> <i>-Institucioni bashkëpunon me RASH dhe QSHA për procedura të regjistrimit dhe të transferimit të studentëve.</i> <i>- Kuotat e pranimit bëhen publike nga IAL-të dhe i përcillen Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Ministrisë përgjegjëse për arsimin.</i> <i>-UGJ, çdo vit akademik harton dhe realizon procedura specifike të bursave dhe ndihmës për shtresat në nevojë.</i> <u>Rekomandim:</u> Institucioni duhet të parashikojë dhe kuota për

	regjistrimin e studentëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara, si dhe i gjithë informacioni duhet të gjendet dhe i afishuar pranë sekretarive			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e Njësisë Bazë si dhe rregulloren e programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Në rregullore është përcaktuar shkalla e frekuentimit për programin e studimit [të detyruara 75% të aktiviteteve të zhvilluara në auditor]. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në sekretarinë mësimore të FSHM mbahet regjistri i frekuentimit të procesit mesimor nga studentët e çdo grupi mësimor, i cili plotësohet për çdo orë mësimore. Në rregullore përcaktohen gjithashtu kriteret dhe procedurat për kalimin nga njëri vit në tjetrin. Studenti lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës, pasi ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në programin mësimor. Informacioni është i aksesueshëm edhe në faqen elektronike të IAL: https://unireald.edu.al/studentet/kalimi-ne-vitin-pasardhes/ [Ev. I.2 Rregullore UGJ; Ev. 1.4 Rregullore e studimeve ne UGJ; Rv. I.5 Rregullore FSHN; Ev. I.7 Rregullore e DSHBMU]
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në rregulloren e IAL, FSHN dhe të programit të studimit, studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të më parshme apo studimeve të pjesshme. Në këto rregullore ka nene specifike për procedura te transferimit apo të ekuivalentimit të lëndëve si dhe për mundësitë e ndjekjes së programeve të dyta të studimeve. Studentët informohen përmes sekretarisë mësimore. Në departament ngrihet një komision ad-hoc, i cili vlerëson dhe njeh kualifikimet e mëparshme bazuar në dokumentacionin, i cili përfshin planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve. I gjithë procesi i transferimit dhe njohjes së krediteve të mëparshme, zhvillohet brënda afatve ligjore dhe ndjek hap pas hapi të gjitha procedurat e përcaktuara në ligj dhe në rregullore. [Ev. I.2 Rregullore UGJ; Ev. 1.4 Rregullore e studimeve ne UGJ; Rv. I.5 Rregullore FSHN; Ev. I.7 Rregullore e DSHBMU; Ev V.5 Ekuivalentim lëndesh mesimore Biologji kimi; Ev 11.20 Procedurat e transferimit]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e	Procedurat e vlerësimit të dijeve janë të detajuara në syllabuset e lëndëve. Në secilin syllabus përcaktohet skema e kontrollit të dijeve e

procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	cila ndahet në vlerësimin e vazhdueshëm dhe provimin përfundimtar. Kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testimeve/provimeve me shkrim/me gojë/projekteve/prezantimeve/praktikave. Në programin e lëndës shprehen modalitete të vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor, në ditën e parë të çdo lënde. Në takimin me studentët GVJ konstatoi se studentët janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies dhe transparencën e vlerësimit. Ata përdorin edhe procedura të rishikimit të vlerësimit. [Vizita në Institucion, takimi me studentët]
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e IAL-së dhe rregulloren e programit të studimit, janë përcaktuar qartë mënyra e diplomimit. Institucioni ka përgatitur dhe një manual udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës. Në rregullore përcaktohet: - Diplomimi bëhet me mbrojtjen e tezës, ose me provim; - Teza nuk është kriter detyrues, ajo përcaktohet në bazë të notës mesatare; - Për tezën e diplomës rregullorja përcakton karakteristikat dhe strukturën e tezës së diplomës; - Kushtet që duhet të përmbushë studenti për marrjen e diplomës dhe procedurën e diplomimit. GVJ konstatoi se emërtimi i diplomës përputhet me programin e studimit dhe objektivat formuese dhe karakterizuese të tij [diploma dhe suplementi i diplomës]. Departamenti përcakton listën e temave të diplomave në fillim të semestrit të parë të vitit të tretë akademik. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti. Lektorët që drejtojnë studentët në përgatitjen e tezës, kanë formimin e duhur. Studenteve ju vihet në dispozicion Programi i provimit përfundimtar në Biologji kimi [Ev. I.9 Rregullore e programit; Ev. II.11.1; Ev. III.11.2 Manual i punimit të diplomës; Ev. III.11]
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletëpalosjeve, posterave dhe organizimit të ditëve informuese [zakonisht në periudhën mars – maj]. Institucioni me anë të strukturave si Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI realizon gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve informuese. Para fillimit të vitit akademik IAL, harton kalendarin përkatës dhe organizon takime me nxënësit maturantë për ti njohur ata me programet e studimit që ofron UGJ. Gjithashtu personat e interesuar, marrin informacion për programet e studimit që ofron IAL, edhe nëpërmjet spoteve publicitare në media të ndryshme. [Ev. II.15 Pjesëmarrje në panair “Work and study”; Ev. V.4 Kalendar i zhvillimit informimit maturanteve; Ev 4.3 Fletëpalosje e UGJ; Ev V.4.4 Poster UGJ]



Konkluzione	<i>-Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit, studenti gjen informacion të plotë në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik nëjetrin, si dhe shkallën e frekuentimit të detyruar për programin e studimit.</i> <i>-Studentët kanë informacion për kriteret e njohjes së kualifikimeve të mëparshme apo studimeve të pjesshme.</i> <i>-Procedura të vlerësimit të dijeve janë të saktësuara në nenet e rregullores së programit të studimit.</i> <i>-Institucioni ka përgatitur dhe një manual udhëzues për përgatitjen e temës së diplomës.</i> <i>-Informimi i publikut për programet e studimit realizohet përmes fletëpalosjeve, posterave dhe organizimit të ditëve informuese. Ky informacion përditësohet dhe në media të ndryshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në “Biologji kimi”, informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen. Përmes kontakteve me Njësinë Bazë, Sekretarinë Mësimore si dhe përmes ëebit ato gjejnë: • Informacion mbi institucionin që ofron programin e studimit; • Informacion për objektivat formuese të programit; • Strukturën dhe organizimin e programit; • Planin mësimor; • Syllabuset; • Rregulloren; • Suplementin e diplomës, etj. Në fillim të çdo viti akademik, bëhen takime me studentët e viteve të para, ku shpërndahet çdo informacion në lidhje strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit. Programi i studimit Bachelor në “Biologji kimi”, zhvillohet në 3 vite akademike, 6 semestra dhe përmban 180 kredite [ECTS]. Forma e studimit është me kohë të plotë.

	[Vizita në Institucion, takimi me studentët; Ev. 1.9 Rregullore e programit bachelor Biologji kimi]
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ konstaton se dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Në këtë dokumentacion, i cili vihet në dispozicion nga çdo lektor i lëndës, në orën e parë të çdo semestri, studenti gjen informacion të detajuar për lëndët e modulet, organizimin dheshpërndarjen e tyre në semestra, ECTS për secilën lëndë e modul, klasifikimin e lëndëve si pas tipit të veprimtarisë formuese. Në syllabuse studenti orientohet për tematikat dhe mënyrën e organizimit të orës së mësimi [leksion, seminar, praktikë]. Informacioni gjendet dhe në faqen zyrtare ëeb te UGJ [www.uogj.edu.al] [Ev. II.9.1 Plani mesimor; Ev II.30 Syllabuset]
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Në takimin me grupin e vlerësimit të brendshëm, GVJ kërkoi informacion mbi mënyrën e orientimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit. Institucioni ka lidhje me institucione private dhe publike, ku marrin informacion për vendet e lira të punës. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, <i>por duhen gjetur menyra te tjera me efikase, per shpalljne e vendeve te punes dhe terheqjen e ish studenteve ne to, sepse ne shumicen e rasteve nuk ka qene funksionale.</i> Institucioni ka mundur të përfshirjen e studentëve në një sërë aktivitetesh informuese në lidhje me kërkesat e punëdhënësve. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitete trajnuese brenda qytetit dhe me gjerë në rajon, shton mundësitë e informimit dhe promovimit të studentëve në tregun e punës. [Vizita në institucion, Takimi me studentët dhe përfaqësues të Zyrës së karrierës dhe Alumni], [Ev 1.23 Lista e marreveshjeve te UGJ; Ev. II.19 Te dhena nga Zyra Alumni; Ev ANEKS – Tab 23 permebledhesete te diplomuarve dhe punesimit]
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët, evidenton që ata informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitet jashtëkurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave mesimore dhe strukturat ndihmëse, në fillim të çdo viti akademik. Në funksion të studentëve është dhe biblioteka dhe shërbimet e sekretarisë. [Vizita në institucion, Takimi me studentët]
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në RVB theksohet se UGJ ka sistemin Pitagora, përmes të cilit mundësohet informimi i studentit për programin e studimit. Studenti disponon një kod personal përmes të cilit mund të aksesojë të dhëna te tij në çdo moment, si dhe detaje për programin e studimit, detajeve individuale për notat etj. Informacioni i detajuar dhe i rifreskuar ndodhet gjithashtu edhe në faqen elektronike të Institucionit: www.uogj.edu.al

	https:uogj.pitagora.rash.al/login			
Konkluzione	-Studentët që ndjekin programin e studimit Bachelor në "Biologji". informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën e programit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. - Dokumentacioni shpjegues për programin e studimit është i plotë dhe i organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nën ligjorinë fuqi. - Gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentojmë që ata informohen hollësisht dhe gjërësisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimi, aktivitet jashtëkurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitetet e organizimit të praktikave mesimore edhe strukturat ndihmëse. <u>Rekomandim:</u> Per ofrimin e vendeve te punes dhe gjurmimin e studenteve duhen gjetur edhe metoda te tjera, per te patur rezultate edhe me te mira.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Në sekretarinë mesimore të FSHN janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve përprogramin e studimit. Sekretaria ka: • Regjistrin themeltar të studentëve; • Regjistrin e lëshimit të diplomave; • Regjistrin me të dhënat akademike [regjistri i notave]; Në takimin me sekretarinë mesimore u informuam se regjistrat në formë të shkruar depozitohen me kohë të pacaktuar dhe arkivohen në arkivën e shtetit. Gjithashtu Institucioni përpunon të dhëna në lidhje me cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve dhe disponon të dhëna në lidhje me punësimin pas diplomimit. [Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mesimore; Ev. III.13; Ev ANEKS Tab 21 Tab përmbledhese cilesia dhe hyrje dhe dalje e studenteve; Ev. II.19]
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo

programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	tërheqjen e studentëve nga programi i studimit. Në sekretari depozitohen dosjet e studentëve të plotësuar sipas kuadrit ligjor në fuqi, listat e frekuentuesve si dhe një numër dokumentacionesh për procedurat e transferimit dhe të çregjistrimit. Këto të dhëna ruhen edhe në sistemin Pitagora dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore dhe zyra e statistikave. Nga vizita në sekretarinë mësimore rezultoi se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon: - Viti akademik 2020-2021 4 studentë; - Viti akademik 2021-2022 8 studentë; - Viti akademik 2022-2023 11 studentë. [Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore; Ev ANEKS Tab 21 Tab permbledhese cilesia dhe hyrje dhe dalje e studenteve; Ev V.14 Lista e te transferuarve dhe te larguarve nga UGJ]
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Për menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, GVJ në takimin me punonjësit e sekretarisë mësimore inspektoi hapësirat e punës dhe arkivimit të dokumentacionit dhe u njoh me një numër dokumentesh si dosja e studentit, dosja e personelit, regjistrat. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga dy struktura përkatëse: Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Sekretaria mësimore. Ato janë të disponueshme si në sekretarinë mësimore në formë shkresore, ashtu edhe në formë elektronike në sistemin Pitagora. Këto të dhëna janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e autorizuar të të dhënave, informacioni personal i studentëve ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahe vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriterëve që përcaktohen në ligjin "Për mbrojtjen e të dhënave personale" si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nën ligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të UGJ. [Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore; Ev. IV.2 Rregullore dhe mbrojtje e te dhenave personale]
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin [sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.], vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të	UGJ ka përpiluar mekanizma ku ndërmjet dhe drejtorive përkatëse, të cilat lidhen me organizimin e punës, kryhen kontrole periodike [auditim të brendshëm] pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve, ku bëhet vlerësimi i dokumentimit dhe menaxhimit të informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar. \ GVJ nuk gjeti raporte auditimi. [Vizita në institucion; Ev. V.7 dhe V.7.1 Kontroll dokumentacioni]

dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Raportet analitike përpilohen në formën e analizës vjetore të njësive bazë dhe asaj kryesore [evidencat e analizave gjenden në dokumentacion]. Në këto raporte ka të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin. Të dhënat e punësimit merren nga Urdhërat profesional, të çdo profesioni. Gjatë takimeve u deklarua që kërkesa të shtuara për punësim ka edhe jashtë Shqipërisë. Zyra e Këshillimi të Karrierës dhe Alumni realizon skedimin e informacionit për punësimin. [Ev. I.11 Raport vjetor; Ev. II.19 Të dhëna statistikore nga Zyra Alumni; ANEKS tab 21 Cilesia hyrje dalje e studentit]			
Konkluzione	<i>-Në sekretarinë mësimore të FSHN, janë të depozituara dokumentacionet e plota për numrin e studentëve për programin e studimit. GVJ konstaton se institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, largimin apo tërheqjen e studentëve nga programi i studimit.</i> <i>-Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të infomacionit.</i> <i>-IAL përpilon raporte në formën e analizës vjetore të cilët përfshijnë të dhëna kryesisht për kalueshmërinë, frekuentimin dhe ecurinë e procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e UGJ dhe Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UGJ. Në RVB theksohet se studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UGJ me një senator i cili zgjidhet nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në: • Këshillat studentore, • Njësinë e sigurimit të brëndëshëm të cilësisë; • Senatin Akademik;

	Grupin e vetëvlerësimit për akreditimin institucional, [Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.] [Ev.2; Ev. 4; Ev. 37] [Vizita në institucion, Takimi me sekretarinë mësimore; Ev. I.1 Statuti UGJ; Ev. II.1.1 Lista e senatit; Ev ANEKS Tab 24 Te dhena per anetaret e NJBSC]
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura, por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Në takimin me studentët, GVJ konstaton se studentët plotësojnë pyetësorë në mënyrë periodike, përfshihen në punë studimore dhe aktivitete promovionale e trajnuese të organizuara nga FSHN. Studentët shprehen të kënaqur për përfshirjen e tyre dhe angazhimin për mbarrëvajtjen dhe përmirësimin e procesit akademik. [Takimi me studentët; Ev. I.1 Statuti IAL; Ev. II.1.1 Lista e senatit]
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Plani mësimor i programit të studimit është ndërtuar mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi duke respektuar të gjitha kriteret për ngarkesën në auditor dhe jashtë tij si dhe për shpërndarjen e ngarkesës në orë teorike dhe praktike. Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Studentët gjykojnë se praktikat në laboratorët simulorë dhe praktikat mesimore, i pregatisin mjaft mirë për tregun e punës. Raportin teori-praktikë e vlerësojnë shumë të mirë. Për tërheqjen e mendimit të studentëve në funksion të përmirësimit të programeve të studimit, institucioni nuk përdor shume mekanizma. Këshilli studentor, është organizmi ku studentët diskutojnë dhe problematikat e trajtuara i adresojnë në forumet drejtuese të FSHN për zgjidhje. Koordinator i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit, për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. <i>Nuk kishin realizuar asnjë pyetësor me studentet, gje qe mendojme do te ndihmonte me mire ne mbarvajtjen e mesidhenies dhe mesimnxenies.</i> [Vizita në institucion, Takimi me studentët dhe koordinatorin e programit të studimit]
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë procedura e vlerësimit dhe e ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe u shprehen se mund të ishte më mirë me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Në bazë të rregullores, departamenti pas procesit të ankimimit, ngre një komision rivlerësimi të ndryshëm nga komisioni i parë, i cili bën rishqyrtim dhe rivlerësim të provimit, <i>por nuk kishin raste konkrete.</i> Procedura u shpjegua si më poshtë: Studenti bën kërkesë për rivlerësimin e tezës së provimit, të cilën e dorëzon në sekretarinë mësimore brenda 48 orëve nga marrja e

	rezultatit të provimit; - Ankesa me shkrim i paraqitet Drejtuesit të Njesisë Bazë, i cili vë në djeni Dekanin; - Dekani brënda 48 orësh nga marrja e ankesës, ngre një komision ad-hoc prej 3 anëtarësh, për të rivlerësuar tezën e provimit; Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije. [Ev. I.4 Rregullore e studimit në IAL; Vizita në institucion, Takimi me studentët]			
Konkluzione	- Studentët janë të përfaqësuar në Senatin e UGJ me një senator i cili zgjidhet nga vetë ata. Studentët janë pjesëmarrës në Këshillet studentorë, në Komisionin e përhershëm për standartet e cilësisë, etj. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB. -Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet edhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën, përfshirjen në projekte e grupe studimore. -Në takimin me studentët ata vlerësuan pozitivisht cilësinë e mësimdhënies. Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit përcaktohet qartë procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. -Koordinatori i programit është në kontakt të përhershëm me studentët dhe shërben si urë komunikimi midis tyre dhe stafit të departamentit për të adresuar problemet që dalin në kohë reale. -Koordinatori kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës. <u>Rekomandim:</u> Duhet të behen pyetesor per vleresimin e mesimdhënies dhe mesimnxënies, sepse ka 4 vjet qe nuk jane realizuar, si dhe per ndryshimin e programeve apo vleresimin e pedagogëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit	UGJ ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve, programin e studimit dhe aktivitete të lidhura me procesin

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 68

të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	mësimor. Në funksion të informimit të studentëve janë: - Zyra e Karrierës dhe ALUMNI; - Sekretaria mësimore; e hapur cdo ditë për studentët dhe ofron shërbim akademik nga regjistrimi në diplomim; - Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë; - Zyra e IT. Zyra e Karrierës realizon informimin e studentëve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë, shpalljen e njoftimeve në ambientet e Universitetit, në ëbsite ose rrjete sociale. Njëkohësisht Zyra e Karrierës ka si funksion parësor të saj ofrimin e mundësive për vende pune, trajnime dhe internship-e për studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar pranë UGJ "Eqrem Cabej". [Ev. I.1 Statuti i UGJ; Ev IV.5 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA (Neni 14).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Sistemi për informimin, këshillimin, ndjekjen dhe përparimin e studentëve i përshkruar në Kriterin 1, është funksional dhe i përshtatshëm. Gjatë vizitës në institucion, studentët u shprehën të kënaqur për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesëmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Të gjithë informacionet e nevojshme në lidhje me procesin mësimor ishin lehtësisht të aksesueshme nga ata, si dhe u shprehën se kishin mbështetjen e nevojshme nga Zyra e Karrierës për çdo çështje, që lidhej me përparimin e mëtejshëm të tyre. [Vizita në institucion, takimi me studentët]
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Në institucion funksionon Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme pranë kësaj zyre. Zyra e këshillimit të karrierës i ndihmon studentët për: • Identifikimin i lidhjeve midis diplomës që do të marrin dhe mundësive për karrierë; • Identifikimin e burimeve për pozicione të veçanta pune; • Zhvillimin e strategjive për mënyrën e të kërkuarit të punës; • Identifikimin e aftësive dhe shprehive. Në këtë zyrë studentët gjejnë mbështetje për përgatitje për intervista pune, shkrimin e CV dhe letrave të motivimit etj. [Vizita në institucion, takimi me studentët dhe me përfaqësues të zyrës së Këshillimit dhe Karrierës]

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Në takimin e GVJ me Zyrën e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës u informuam se kjo zyrë asiston në gjurmimin e studentëve edhe pas diplomimit. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data - bazë të të dhënave, të cilat përditësohen çdo vit. <i>Keto te dhena kane dhe veshtiresi per t'i mbledhur, per shkak te largimit te te diplomuarve, ndryshimit te numrit te telefonit, ose mos deshires per te mbajtur kontakte me institucionin.</i> Këto të dhëna gjurmimi të studentëve pas përfundimit të studimeve u vihen në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë kontakte të vazhdueshme midis studentëve të diplomuar dhe FSHN dhe Departamentit të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit. Të dhënat dhe statistikën në lidhje me punësimin e studentëve të programeve të tjera të studimit, ndihmojnë studentët për zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe ngritjen e një karriere të sukseshme. [Ev. V.13 Formular gjurmimi i studenteve; Ev V.13.2 Plani vjetor I punes per keshillim karriere; Ev 11.9 Te dhena statistikore nga Zyra Alumni; Vizita në institucion, takimi me studentët dhe me përfaqësues të zyrës së Këshillimit dhe Karrierës]			
Konkluzione	<i>-FSHN ka procedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</i> <i>-Në institucion funksionon Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, pranë së cilës studentët gjejnë mbështetje dhe informacione të vlefshme.</i> <i>-Kjo zyrë mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit, si dhe ka krijuar një data - bazë të të dhënave, të cilat përditësohen çdo vit.</i> <i><u>Rekomandim:</u> Per gjurmimin duhet nje sistem me i mire, per te patur te dhena me te sakta per punesimin e studenteve, gje qe u mungonte.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Implementimi dhe përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies më qëllim rritjen e cilësisë akademike është një proces i rëndësishëm në përmirësimin e performancës së institucioneve të arsimit të lartë. UGJ në strategjinë e zhvillimit institucional, një vënd të rëndësishëm i kushton zhvillimit të metodave inovative të mësimdhënies me qëndër studentin duke promovuar mendimin kritik, dialogun student/pedagog dhe përgatitjen e studentëve të aftë, për tu përshtatur kërkesave të tregut të punës. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstaton se UGJ, ka hartuar disa udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Përmëndim këtu manualët e përdorimit të teknologjisë në distancë, apo manualin për punimin e diplomës. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht përmes pjesëmarrjes në projekte të ndryshme, zhvillimit të leksioneve të hapura nga lektorë të ftuar jashtë universitetit, vizitat studimore ej. [Ev. III.5 Udhëzim mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të mësimdhënies; Ev. III.5.1 TECOMP Kompetencat digjitale; Ev. III.1 Implementimi i Classroom; Ev. III.1.2 Implementimi i metode Edumet; Ev.III.1.5 Manual i TEAMS; Ev IV.18 Urdher për përdorimin e platformes Learning key].
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel Institucional, i cili monitoron dhe vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. Kështu pranë UGJ - është ngritur dhe funksionon NJSBC, në bazë të Rregullores së NJSBC, ku përshkruhet si funksionojnë dhe bashkërendojnë punën njësia qendrore me njësitë në çdo fakultet. Njësia ka në përbërjen e saj staf akademik staf administrativ, dhe studentë. Sektori i Kurikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore monitoron në mënyrë periodike cilësinë e programeve të studimit, aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies, rekrutimin e stafit me gradat dhe titujt e duhura, anketimet dhe kontrollat e vazhdueshme të procesit mësimor, si dhe çdo aktivitet që shërben në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe jetës studentore. Vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së programit duhet të realizohet nëpërmjet pyetësorëve, të cilët duhet të përgatiten nga NJSBC dhe miratohen nga senati. Çdo vit duhet të realizohen pyetësorë për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies si: pyetësorë për vlerësimin e lëndës, për vlerësimin e lektorit dhe Infrastrukturën, por ka 4 (kater) vjet që nuk është realizuar asnjë pyetësor me studentet. Gjithashtu analizohet kalendari i realizimit të aktiviteteve të aprovuar në fillim të çdo viti akademik, pyetësorët e vetvlerësimit të stafit akademik, gje që gjithashtu nuk janë realizuar. Këto u theksuan dhe gjatë takimit me

	<i>stafin akademik dhe studentët. Në fund të çdo viti akademik NJSBC duhet të hartojë raportin vjetor që e prezanton tek rektori së bashku me konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse.</i> [Ev. VI.6 Raport vjetor i Sktorit të Standarteve të Cilesise dhe Kurrikulave; Ev. VI.8 Rregullore e NJSCB, Neni 3]
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Bazuar në statutin e institucionit, studentëve u garantohej e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe të komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. Studentët janë pjesë aktive e vlerësimeve periodike të procesit të mësimdhënies. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë, studentët plotësojnë pyetësorët për vlerësimin e metodave të mësimdhënies. Në fund të çdo viti akademik, Institucioni përpilon raportin bazuar në të dhënat e tërhequra nga këta pyetësorë. Studentët janë në fokusin kryesor të Strategjisë së zhvillimit institucional dhe kontribuojnë në mënyrë direkte në vlerësimin e Institucionit në përgjithësi ashtu dhe të programeve apo lëndëve specifike. [Ev. III.6 Procedura për ngritjen dhe zhvillimin e pyetësorit; Ev.I.1 Statuti i UGJ; Ev.I.4 Rregullore e studimit UGJ; Ev.V.10.1 Ngritja e GVB se Programit]
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pranë UGJ funksionon Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studenteve për matjen e performancës. Në fund të çdo semestri kjo strukturë organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi. Të dhënat publikohen periodikisht me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë. Me tej strukturat përgjegjëse hartojnë një raport në përfundim të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të UGJ. Ky raport realizohet në zbatim të politikave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 103: "Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë". UGJ ne faqen zyrtare publikon materiale te aksesueshme https://uogj.edu.al/transparenca [Ev. I.1 Statuti UGJ; Ev. III.7 Analiza e pyetesoreve dhe percjellja ne fakultete; Ev VI.6 Rraport vjetor i SSCK; Ev VI.1 Vendim senati per miratimin eprogramit te transparences; Ev I.13.2 Raport i veprimtarise ne DSHBMU]
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	GVJ vlerëson së të dhënat në raportin përfundimtar janë përshkruese në terma sasore dhe analitike si dhe me adresim të problematikave të hasura. Këto të dhëna shërbejnë promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies, si përcaktimin e kriterëve dhe afateve për rishikim të kurikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e teksteve mësimore dhe aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj. [Ev. I.1 Statuti UGJ; Ev. I.11.4 Raport vjetor i UGJ; Ev I.12.4 Raport vjetor i analizes FSHN; Ev. VI.4.1 Plani vjetor i veprimtarive te FSHN; Ev. III.7 Analiza e pyetesoreve dhe

	percejllja ne fakultete; Ev VI.6 Rraport vjetor i SSCK; Ev I.13.2 Raport i veprimtarise ne DSHBMU]			
Konkluzione	-Institucioni ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë në nivel institucional, i cili monitoron e vlerëson periodikisht cilësinë e programit të studimit. -Studentëve u garantohet e drejta për të qënë pjesë aktive e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe e komisioneve të tjerë në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti. - NJSBC në fund të çdo viti harton një raport në nivel institucional. -Të dhënat e raportit të NJSBC i shërbejnë promovimit të praktikave të mira dhe nxitjes së stafit akademik për përmirësim të mësimdhënies si dhe përcaktimin e kritereve dhe afateve për rishikim të kurikulave, hartimin e procedurave për përzgjedhjen e tekseve mësimore dhe aplikimin e teknologjisë mësimore, përmirësime të infrastrukturës mësimore etj. <u>Rekomandim.</u> Te gjithë manualat dhe vendimet duhet te mbështeten ne pyetesoret qe duhet te aplikohen, sepse ka 4 vite qe nuk aplikohen pyetesoret tek studentet.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë [SBC], në përputhje me parashikimet ligjore e nënlige në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka hartuar politika dhe procedura, si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në rang Universiteti. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UGJ, në rregullore ne institucionit si dhe në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2020-2025. Objektivat e sigurimit të cilësisë evoluojnë në përputhje me analizën e situatës dhe me qëllimet e objektivat e zhvillimit të institucionit. Senati akademik është aktiv në mbështetje të implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë. [Ev. I. 3 Strategjia e zhvillimit te UGJ 2020-2025; Ev. I.1 Statuti i UGJ; Ev. III.6 Procedura per ngritjen e zhvillimin e pyetesorit; Ev. I.11.4 Raport vjetor i UGJ; Ev I.12.4 Raport vjetor i analizes FSHN; Ev. VI.4.1 Plani vjetor i veprimtarive te FSHN; Ev. III.7 Analiza e pyetesoreve dhe percejllja ne fakultete; Ev VI.6 Rraport vjetor i SSCK; Ev I.13.2 Raport i veprimtarise ne DSHBMU]
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion	UGJ ka ngritur Sistemin e brëndëshëm të Sigurimit të Cilësisë, ku përfshihen edhe studentë dhe bashkëpunëtorë të jashtëm, <u>te specifikuar</u>

Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<u>sipas fushave të studimit që ofron IAL</u>. Ky sektor mbulon të gjithë problematikat nga licensimi në akreditim. NJSBC e bazon aktivitetin e saj në: - Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 - Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë [VKM 531/11.09.2018]; - Statutin e institucionit; - Vendimet e senatit; - Urdhërat e brendshëm ; Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit. NJSBC ka detyrim institucional hartimin e raporteve. NJSBC funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktiviteteve si: Përcakton pyetësorët në nivel institucional për matjen e cilësisë në disa nivele, bashkërendon procesin ndërmjet njësive në nivel institucional, monitoron procesin, mbledh informacione, evidenton problematikat, ofron udhëzime dhe rekomandime në njësitë bazë, administron dokumentacione, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm, <i>por nuk ka aplikuar pyetësor prej disa vitesh</i>. NJSBC mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë si dhe interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë. [Ev. I.1 Statuti UGJ; Ev. VI.8 Rregullore e NJSBC]
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UGJ i është nënshtruar procesit të akreditimit institucional, dhe ka marrë masat përkatëse për të përmbushur rekomandimet e ekspertëve të jashtëm [Ev. I. Vendim i Akreditimit Institucional periodik]. GVJ në bazë të dokumentacionit dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC, evidenton që institucioni ka përdorur mekanizma të tillë si ato të vlerësimit të anëtarëve të stafit akademik, vetëvlerësimit të pedagogëve, vlerësimin e infrastrukturës, <u>por jo shumë fikase dhe në nivelin e duhur</u>. Njësia e sigurimit të brendshëm, deklaron se bën vlerësim periodik të veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore të UGJ, si dhe harton raportet përkatëse të vlerësimit të brendshëm. Metodatat të cilat janë aplikuar: inspektime gjatë zhvillimit të mësimin, leksione të hapura, intervista, vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës etj., <u>por gjithashtu u vërejt mungesa e pyetësoreve</u>. [Ev. 6 Rregullore e NJSBC; Ev.a VI.3 Manuali i Cilësisë në UGJ; Takimi në institucion].
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë,	Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, UGJ ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja. Treguesit e performancës përfshijnë tregues të tillë si: niveli i regjistrimeve, niveli kalueshmërisë, niveli idiplomimit, diversiteti i profileve studentore, ndërkombëtarizimi etj. NJSBC përpaket për monitorimin e proceseve të

institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë standartizuar si procese që kryhen si në nivel institucional, ashtu edhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në baze të Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë [VKM 531/11.09.2018]. [Ev. V.13.2 Plani vjetor i zyres Alumni , Keshillimit të Karrieres; Ev. VI.6 Raport i Sektorit SCK];			
Konkluzione	-Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura, si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucional. -NJSBC kryhen monitorimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë, të cilat janë të standartizuara si procese që kryhen në mënyrë periodike, si në nivel institucional dhe në nivel programi studimi, duke realizuar vlerësime analitike e krahasuese, si dhe procese të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. - Për të analizuar arritjet në nivel institucional si dhe kontributin e tyre për arritjet e objektivave strategjike, UGJ ka përcaktuar dhe treguesit e performancës. Lista e treguesve të performancës realizohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme nga NjBSC-ja dhe i propozohet për miratim Senatit Akademik. Rekomandim: Aplikimi i pyetesoreve me studentet duhet të rinise dhe të analizohen, si dhe Raportimet vjetore duhet të jene me te plota.GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetje e evidentuar në pjesën përshkrimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave	FSHN përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herë pas hershme të programit të studimit. Disa nga instrumentat e përdorur janë analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënjes së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike. Miratimi i programit të studimit kalon nëpërmjet një procedure formale, e cila nis me propozimin e Njesisë bazë, miratimin në Dekanat dhe miratimin në Senatit Akademik. Ky i

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: www.ascal.al

Faqe 75

dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	fundit ja kalon për miratim Bordit të Administrimit. Institucioni ka ngritur dhe ka funksionale një njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikqyrjen dhe rishikimin e programeve të ciklit të parë të studimeve, që të vlerësojë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive kërkimore-shkencore në njësisë kryesore të FSHN në përputhje me standardet si dhe të monitorojë punësimin e studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga IAL. Në përmbushjen e këtyre qëllimeve gjatë diskutimeve me drejtuesit u theksua se një rol të rëndësishëm kanë departamentet e FSHN, ku koordinatori i programeve realizon funksione specifike në lidhje me rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u bazuar gjithmonë në parashikimet ligjore dhe në strategjinë e sigurimit të cilësisë së IAL. Proçesi i monitorimit dhe shqyrtimit të programit të studimit kryhet kryesisht mbi bazën e veprimtarive të përgjithshme dhe në funksion të cilësisë. Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, <i>GVJ nuk ka identifikuar rezultate të proçeseve të anketimit të studentëve, sepse nuk ka realizuar anketime.</i> Njësia luan rol kryesor në hartimin e planit të punës si dhe duhet të përfshirje metoda të tërthorta të vlerësimit dhe verifikimit, të cilat do të sigurojnë që rezultatet t'i përafrohen realitetit në të cilin ndodhet institucioni. <i>NJSBC është duke plotësuar dhe konsoliduar veprimtarinë e saj, duke u bazuar në rekomandime dhe plane pune që adresojnë përmirësimin e problematikave të evidentuara.</i> [Ev. I.11.4 Raporti vjetor i UGJ; Ev. I.12.4 Raporti i FSHN; Ev. I.13.2 Raporti DSHBMU; Ev. VI.6 Raport i Sektorit SCK; Vizita në Institucion]
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim, në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Të dhënat e vlerësimit përfshihen në raportet vjetore të departamentit dhe FSHN. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. Të dhënat i dërgohen Senatit të UGJ, duke krijuar mundësi më të shpejtë adresimi dhe zgjidhje të problematikave. UGJ duke vlerësuar situatën e krijuar harton planin e masave konkrete në përmirësim të cilësisë së proçesit mësimor. Kjo ka ndodhur në paktën dy raste: - Plan i masave për minimizimin e rreziqeve për shkak të gjëndjes së fatkeqsisë natyrore të shkaktuar nga Pandemia Covid-19; - Plan i masave që lidhet me realizimin e detyrave të palnifikuara; [Ev. I.11.4 Raporti vjetor i UGJ; Ev. I.12.4 Raporti i FSHN; Ev. I.13.2 Raporti DSHBMU; Ev. VI.6 Raport i Sektorit SCK]

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Departamentet e FSHN në UGJ, analizojnë mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit dhe reflektojnë vlerësimin e tyre në dokumentin e analizës vjetore. Elementët e analizës janë: - Numri i studentëve frekuentues; - Funksionimi i këshillimit akademik dhe koordinimit të praktikave; - Plotësimi i standarteve të grupeve mësimore; - Plotësimi i standarteve të stafit akademik; - Plotësimi i standarteve të didaktikës dhe laboratorëve; - Kalueshmëria dhe cilësia semestrale ; - Kalueshmëria dhe cilësia në provimin e praktikës profesionale; - Numri i të diplomuarve; - Konkluzionet e pyetsorit të studentëve.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar [alumni], të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi. Një vend të rëndësishëm në këtë vlerësim zë informacioni i përpunuar nga Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni për punësimin e studentëve. Përmes kësaj zyre mbahen kontakte me studentë që kanë përfunduar më parë programin e studimit, si dhe merret informacion për punësimin e tyre apo kualifikimet e mëtejshme pas përfundimit të programit të studimit, ne pak raste, sepse ne shumicën e rasteve nuk ka të dhëna. Metoda të tjera <u>duhet të ish</u> sondazhet me studentët aktual që ndjekin programin e studimit. Këto sondazhe, <u>te përfunduar ne disa vite, do të shërbenin</u> për të vlerësuar si mirëpritën studentët në tregun e punës dhe si vlerësohet aftësia që ata kanë fituar nga programi i studimit dhe integrimi i tyre në tregun aktual. Rezultatet bëhen publike nëpërmjet një raporti të shkruar apo dhe takimeve të hapura me stafin akademik të njësisë kryesore, me qëllim evidentimin e problematikave të hasura dhe mundësitë për ndryshime në programin e studimit, në mënyrë që të rritet cilësia e mësimdhënies. [Vizita në institucion, Takimet me përfaqësues të zyrës së Karrierës dhe Alumni; Ev. VI.7 ANEX Tab 23 Te dhëna për diplomim dhe punësim]
Konkluzione	<i>-UGJ përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herë pas herës të programit të studimit.</i> <i>-Njësia kryesore, në fund të çdo viti akademik përgatit analizën vjetore e cila i përcillet departamenteve për konsultim dhe reflektim në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</i>

	-Të dhënat e vlerësimit të programeve të studimit përfshihen në raportet vjetore të UGJ. Në mbledhjet e departamentit ku analizohen të dhënat e vlerësimit, hartohet dhe plani i masave për adresimin e mangësive dhe përmirësimin e cilësisë. -Për vlerësimin e realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit institucioni nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë, përdor një numër instrumentash të tërthorta vlerësimi si nr. e studentëve të licensuar, të punësuar etj. <u>Rekomandim:</u> Per vlerësimin e cilesise se programit duhen realizuar pyetesor e sondazhe me studentet, si dhe gjurmimi me mi mire e me efikas i te diplomuarve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në statutin, rregulloren dhe planin strategjik 20201-2025 të UGJ, përfshihen politikat që do të ndërmerren për të përmirësuar programin e studimit në përputhje me konventën europiane, planin e ndërkombëtarizimit të UGJ, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare në mënyrë që programi i studimit të njihet sa më lehtë në vëndet e huaja dhe/ose realizimin e diplomave të dyfishta. Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor, do realizohen nëpërmjet zhvillimit të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve. Për përmirësimin e vazhdueshëm i cilësisë së programeve të studimit, institucioni ka përfshirë aktorët e brendshëm dhe të jashtëm në hartimin e politikave të zhvillimit strategjik dhe në politikat e ndërmarra për ndërkombëtarizimin e programit të studimit. [Ev. I.1 Statuti UGJ; Takim me studentet]
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u takua me aktorë të rëndësishëm të jetës akademike, Dekanin e FSHN, Përgjegjësin e Departamentit të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe të Ushqimit, Përfaqësues të Stafit Akademik, Grupin e Vetëvlerësimit, përfaqësues të NJSBC dhe Zyrës së Karrierës dhe studentët. Në këto takime doli në pahorganizimi i mirë i punës së përditshme, koordinimi dhe angazhimi optimal në procesin e akreditimit, motivimi, përgjegjësia dhe entuziazmi për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në rregulloret e institucionit dhe në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar qartë detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin të koordinuar, për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim

	për punën dhe kapacitetet e tyre. Institucioni tregoi aftësi menaxhuese dhe drejtueselargpamëse dhe përforcoi ndjesinë pozitive se stafi jep më të mirën duke punuar e bashkëvepruar konform rregullave, në harmoni të plotë. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB. [Vizita në institucion; Ev. I.1 Statuti UGJ; Ev. IV.5 Rregullore e DSHNA; Ev I.7 Rregullore e DSHBMU].
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	NJSBC funksionon në nivel institucioni UGJ, dhe koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Biologji Kimi" njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit, siç është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ, dhe sigurisht të studentëve. DSHBMU, është organ kolegial dhe miratohet me vendim të Senatit Akademik.]. [Ev. VI.8 Rregullore NJSBC; Ev. IV.5 Rregullore e DSHNA].
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në përfshirjen dhe aktivizimin e aktorëve të brendshëm në proceset e vlerësimit, është respektuar liria dhe etika akademike si dhe kuadri ligjor, për mbrojtjen e të dhënave personale. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetësori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Proçedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UGJ. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget çdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studentëve. [Ev. I.1 Statuti UGJ; Ev. VI.8 Rregullore NJSBC; Ev. IV.5 Rregullore e DSHNA]
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit është përfshirë dhe një ekspert i jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon. Në procesin e vlerësimit institucioni realizon takime me ish studentë të diplomuar, biokimiste specialistë, ekspertë të fushës, të cilët japin mendime të vlefshme në lidhje me përmirësimin e programit të studimit dhe lidhjen më efektive me kërkesat e tregut të punës. [Ev. I.1 Statuti i UGJ; Ev. III.10 Kodi etikës].
Konkluzione	<i>-NJSBC funksionon në nivel institucioni, e cila koordinon sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjitha njësitë kryesore dhe me tej në njësitë bazë.</i> <i>-Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit Bachelor në "Biologji kimi", njësia bazë garanton përfshirjen e të gjithë strukturave, të cilat janë përgjegjëse për programin e studimit,</i>

	<i>siç është personeli akademik, ndihmës akademik e administrativ, sigurisht dhe të studentëve.</i> <i>-Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor do realizohen nëpërmjet zhvillimit të projekteve kërkimore të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve.</i> <i>-Në procesin e vlerësimit të brëndëshëm të programeve të studimit, institucioni ka përfshirë dhe një ekspert të jashtëm nga institucionet bashkëpunuese, proces të cilin GVJ e inkurajon.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të Universitetit. Statuti, Rregulloret, vendime të senatit, etj, gjenden të publikuara në këtë faqe të hapur për publikun e interesuar. Informacionet përcillen dhe në formë shkresore në njësinë kryesore dhe njësitë bazë, ku janë të aksesueshme nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe studentët. Raporti i NJSBC është publik dhe i aksesueshëm nga studentët dhe publiku në faqen eeb të IAL: www.uogj.edu.al
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	NJSBC realizon pyetësorët institucional në fund të çdo viti akademik, të cilët publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Në hartimin e raportit, NJSBC respekton lirinë akademike dhe kodin e etikës si dhe kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale [ligji 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”]. Raporti i monitorimit i komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik iu komunikohen stafit akademik. Institucioni publikon raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet elektronike, për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar. [Intervista me stafin akademik dhe studimit; Ev. III.10 Kodi etikes; Ev.VI.6 Raporti I Sektorit te Standarteve te Cilesise dhe Kurrikulave]
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë	Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Në analizën e saj NJSBC-ja informon njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat

përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	e forta dhe dobësitë e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese. Këto raporte krahas rezultateve kanë dhe rekomandimet përkatëse apo adresim të problematikave, të cilat synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara. [Takimi me stafin akademik, RVB; Ev.VI.6 Raporti I Sektorit të Standarteve të Cilesise dhe Kurrikulave]
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Nga shyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatohet se FSHN dhe departamenti i Biologji kimisë, kanë zhvilluar një sërë aktivitete me studentët dhe stafin akademik për informimin, aftësimin e tyre për zgjidhjen e situatave të ndryshme në praktikën klinike, aktivitetet kërkimore-shkencore, konferenca shkencore e studentëve dhe stafit akademik në funksion të sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. [Takimi me stafin akademik, RVB; Ev. I.21.1 Plani veprimtari për Akreditimin institucional]
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Me qëllim ngritjen e kulturës së cilësisë, institucioni organizon aktivitete dhe seminare informuese me studentët dhe personelin, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në IAL. Këto realizohen nëpërmjet: - Takimeve të drejtpërdrejta me studentët; - Publikimeve të ndryshme në rrjetet promovuese online të UGJ; - Publikimit të njoftimeve në llogaritë personale në Sistem. Në mënyrë periodike organizohen në bazë departamenti apo fakulteti, aktivitete të ndryshme, seminare, ëorkshop, trajnime, leksione të hapura, konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara me referues nga FSHN si dhe ekspert nga brenda dhe jashtë vëndit. Këto aktivitete janë edhe në website-in e KUR: https://uogj.edu.al/ [Ev. II.15, II.15.1 Panairi Ëork and study]
Konkluzione	<i>-Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare, on line të universitetit.</i> <i>-NJSCB duhet te realizoje pyetësorët institucional në fund të çdo viti akademik, të cilët duhet te publikohen rregullisht duke rritur transparencën. Raporti i monitorimit u komunikohet strukturave e autoriteteve përkatëse, rezultatet e vlerësimit i komunikohen studentëve, raportet e vlerësimeve të personelit akademik e ndihmës akademik u komunikohen individëve dhe merren masat korrigjuese përkatëse.</i> <i>-Raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese. Këto raporte krahas rezultateve kanë dhe rekomandimet përkatëse apo adresim të</i>



	<i>problematikave, por jo te verejtura per kete fushe studimi. të cilat synojnë përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	



Analiza SWOT për programin e studimit Bachelor në "Biologji Kimi" në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër.

Pikat e forta:

1. Programi është në përputhje me misionin e universitetit dhe synon të ruajë vlerat kombëtare, duke kontribuar në zhvillimin e dijes dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj për zhvillimin e vendit.
2. Universiteti ka vendosur dhe zbatuar marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me aktorë të biznesit vendas dhe ndërkombëtarë, në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.
3. Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Departamenti i Shkencave Biologjike Mjedisore dhe Ushqimit kanë një strukturë të mirëorganizuar dhe të qëndrueshme për të mbështetur programin e studimit.
4. Departamenti ka shprehur interesin për të hartuar programe të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe ndërkombëtarë, duke hapur mundësi për shkëmbim njohurish dhe përvojash.
5. Programi është në përmirësim të vazhdueshëm, duke u përditësuar për të përmbushur kërkesat e reja akademike dhe të tregut të punës, çka ofron mundësi për avancimin e cilësisë së arsimit.

Pikat e dobëta:

1. Programi aktualisht nuk përfshin zhvillimin e praktikës profesionale, e cila konsiderohet si një mangësi dhe pikë e dobët në përputhje me rregulloret e vendosura për programet Bachelor. (Standardit I.2, Kriteri 3).
2. Struktura e veprimtarive formuese dhe përqindjes së krediteve për lëndët plotësuese, duhet rishikuar për të siguruar një organizim më të qartë dhe të përshtatshëm të programit. (Standardit II.1, Kriteri 3).
3. Mungesa e vlerësimit të veçantë nga pyetësorët. (Standardit III.2, Kriteri 4 dhe standardi VI.1).
4. Mungesa e një sistemi të mirëorganizuar për gjurmimin e të diplomuarve pengon mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi punësimin e tyre. (Standardi V.6, Kriteri 4).

Rekomandime:

1. Përfshirja në program e praktikave profesionale në kurrikul, në përputhje me kërkesat e vendosura për programet Bachelor. Kjo do t'u mundësojë studentëve të fitojnë përvojë praktike dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për t'u përgatitur për tregun e punës.
2. Të rishikohet struktura e veprimtarive formuese dhe përqindja e krediteve për lëndët plotësuese. Kjo do të ndihmojë në sigurimin e një organizimi të qartë dhe të balancuar



të programit, duke garantuar që studentët të marrin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme në mënyrë të përshtatshme.

3. Institucioni duhet të implementojë një sistem të veçantë vlerësimi duke përdorur pyetësorë për të mbledhur feedback nga studentët dhe të diplomuarit. Kjo do të ofrojë informacione të vlefshme për përmirësimin e programit dhe do të sigurojë që nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut të punës të adresohen në mënyrë efektive.
4. Rekomandohet zhvillimi dhe implementimi i një sistemi të mirëorganizuar për gjurmimin e të diplomuarve. Ky sistem do të ndihmojë në mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi punësimin e të diplomuarve, duke siguruar që universiteti të ketë informacione të rëndësishme për suksesin e programit dhe përmirësimin e tij të vazhdueshëm.
5. Portali i UGJ-së duhet të shërbejë si një platformë qendrore ku studentët mund të kenë akses në informacione të përditësuara dhe materiale mësimore të pedagogëve, duke përmirësuar mbështetjen akademike dhe ndjekjen e kurrikulave.
6. Për të përmirësuar vlerësimin e cilësisë së programeve, është thelbësore të rinisë përdorimi i pyetësorëve dhe sondazheve me studentët, si dhe të zbatohet një metodologji më e saktë dhe më efektive për gjurmimin e të diplomuarve.
7. Literatura duhet të përditësohet me burime të reja dhe relevante që pasqyrojnë zhvillimet e fundit në fushat përkatëse, duke zëvendësuar materialet e vjetëruara dhe leksionet e krijuara nga vetë pedagogët.



SWOT Analysis for the Bachelor's study program in "Biology-Chemistry" at "Eqrem Çabej" University of Gjirokastrë

Strengths:

1. The program aligns with the university's mission and aims to uphold national values by contributing to the development of knowledge and the preparation of young scientists for the country's development.
2. The university has established and implemented fruitful collaborations with similar institutions both domestically and internationally, as well as with local and international business actors, in line with the institution's development strategy.
3. The Faculty of Natural Sciences and the Department of Environmental Biological Sciences and Food have a well-organized and stable structure to support the study program.
4. The department has expressed interest in developing joint programs with other higher education institutions, both domestic and international, thus opening up opportunities for the exchange of knowledge and experiences.
5. The program is continuously improving, being updated to meet new academic and labour market demands, which offers opportunities for advancing the quality of education.

Weaknesses:

1. The program currently does not include the development of professional practice, which is considered a shortcoming and a weakness in accordance with the established regulations for Bachelor's programs. **(Standard I.2, Criterion 3).**
2. The structure of formative activities and the percentage of credits for supplementary courses should be reviewed to ensure a clearer and more appropriate organization of the program. **(Standard II.1, Criterion 3).**
3. There is a lack of specific evaluation through questionnaires. **(Standard III.2, Criterion 4 and Standard VI.1).**
4. The absence of a well-organized system for tracking graduates hinders the collection of accurate and updated data on their employment. **(Standard V.6, Criterion 4).**

Recommendations:

1. The inclusion of professional practices in the curriculum, in accordance with the established requirements for Bachelor's programs. This will enable students to gain practical experience and develop the necessary skills to prepare for the job market.
2. The structure of formative activities and the percentage of credits for supplementary courses should be reviewed. This will help ensure a clear and balanced organization of



the program, guaranteeing that students acquire the necessary knowledge and skills in an appropriate manner.

3. The institution should implement a specific evaluation system using questionnaires to collect feedback from students and graduates. This will provide valuable insights for program improvement and ensure that the needs of students and labour market demands are effectively addressed.
4. It is recommended to develop and implement a well-organized system for tracking graduates. This system will aid in collecting accurate and up-to-date data on graduate employment, ensuring that the university has important information on the success of the program and its continuous improvement.
5. The UGJ portal should serve as a central platform where students can access updated information and teaching materials from lecturers, improving academic support and curriculum tracking.
6. To improve the evaluation of program quality, it is essential to resume the use of questionnaires and surveys with students, as well as to implement a more accurate and effective methodology for tracking graduates.
7. The literature should be updated with new and relevant sources that reflect the latest developments in the respective fields, replacing outdated materials and lectures created by the lecturers themselves.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR			X	
VLERËSIMI TËRËSOR				X



